

Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. Nr. 7(15). Korrik 2007 Çmimi: 50 lekë

"Tre shembuj qytetarie"



Munir Shehu, Rexhep Doda e Ulvi Shehu nderohen me titullin "Qytetar Nderi" nga Këshilli i Qarkut të Dibrës dhe Bashkia e Peshkopisë

— FAQE 3

BUXHETI SHITESË I QEVERISË

Dritë jeshile për Rrugën e Arbërit

U bë shkak ndoshta shpërndarja e buxhetit suplementar që qeveria të zgjidhë dhe qesen për Rrugën e Arbërit. Kjo është vetëm një segment i asaj traseje, por ama dibranët le të shpresojnë se panë një dritë në fund të tunelit. Pikërisht për segmentin Bllatë-Bulqizë me gjatësi qeveria miratoi fondin prej 300 000 000 lekësh dhe ky fond i ndarë në Bulqizë-Bllatë Lot 1 100 000 000. Bulqizë - Bllatë Lot 2 100 000 000 dhe Bulqizë-Bllatë Lot 3 100 000 000. Pra nga buxheti suplementar i shteti përfiton dhe Rrugë e Arbërit 300 000 000 lek në një trase prej 17 kilometrash. Shpresojmë se të jetë një sinjal i mirë ky investim i vogël që bëhet në këtë rrugë aq të përfolur vitet e fundit nga mediat. Ndoshta, ndoshta qeveria e ka marrë seriozisht kërkesën e dibranëve për të pasur rrugën e tyre, ndoshta ka ardhur tamam koha që Rrugë e Arbërit si korridori kryesor i vendit lindje-perëndim të përfundojë. Megjithatë le t'ia lëmë kohës. Ky është një sinjal pozitiv që qeveria dha. Kjo është një dritë në fund të tunelit. Urojmë që të mos mbetet e tillë. /Sh.Skarra

Festë sportive me nxënësit e shkollave në Peshkopi

Nga Haki DUKA
Faqe 10

REFERAT NË KUVENDIN TEKNIKO-SHKENCOR PËR "RRUGËN E ARBËRIT"



RRUGA E ARBËRIT dhe ndërtimi i autostradave në Maqedoninë veriperëndimore dhe lidhshmëria me Kosovën

Nga Ing. SHEFKI ALITI

Faqe 5

OPINIONE

FAQE 4

Kërkohet një Komision i Përhershëm për ndërtimin e Rrugës së Arbërit

Nga SULEJMAN TOMÇINI
Ambasador

Rrugë e Arbërit, Hidrocentrali i Skavicës, Bulqiza dhe dyshimet e mia ...

Nga BUJAR KAROSHI

"Kalorësi fisnik i historisë së psikologjisë shqiptare"



Nga Dr. LAURANT BICA

Nuri Abdiu është një ndër themeluesit e shkollës së sotme psikologjike shqiptare dhe një nga ata që ka përgatitur kuadro dhe për këtë shkollë, një ndihmesë kjo me vlerë kombëtare dhe më gjerë...

(Lexoni në faqe 9)

HISTORI EMIGRACIONI / Një vit vuajtje të vogëlushes Fitore Bahtiri te prindërit e saj në SHBA

Bashkimi familjar përplot me trauma

Nga REXHEP TORTE
(Lexoni në faqe 8)

Viçat hormonalë, ja si kryhet kontrabanda me Maqedoninë

Nga SUAT SAQIPI, Maqedoni
ARDIT SELAMI, Shqipëri
Faqe 6

Golloborda, skaji i harruar i Shqipërisë lindore

Nga ARTAN HOXHA
Faqe 7

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

"Unë jam Hasja e Kaloshit"

Nga NAIM PLAKU
Faqe 11

Flakët pushtojnë Korabin, Lurën dhe Ternovën

Prej ditësh malet e Dibrës vazhdojnë të digjen nga flakët e shumta të zjarreve që kanë rënë në to. Qindra hektar me pyje, në rrethet Dibër, Bulqizë dhe Mat janë shkumbuar, në pamundësi për shuarjen e vatrave të shumta të zjarreve të rëna, pasi terreni tepër malor dhe i vështirë nuk ka mundësuar në asnjë rast ndërhyrjen e zjarrfikësve. Sipas informacioneve të drejtorisë së shërbimit pyjor, deri më tani, nuk ka mbetur ekonomi pyjore në këto rrethe, që të mos jetë përfshirë nga flakët e zjarreve të fuqishme. Ndër zonat më problematike, janë ata të Lurës, Selishtës, Slllovës në Dibër; Zall-Gjoçaj, Macukull në Mat; dhe

Shupenzë, Zerqan, Ternovë, Gollobordë në Bulqizë.

Nga zjarret e rëna në masivin pyjor të Ternovës, në rrethin e Bulqizës, është vënë në rrezik djegie edhe "parku natyror" i Liqenit të Zi, pasi flakët nga momenti në moment, mund të arrijnë te ky park, i vetmi nga ekonomitë pyjore të këtij rrethi, që ende nuk është prekur nga zjarret. Në mbrojtje të tij kanë ardhur edhe forca të ushtrisë, që po punojnë intensivisht së bashku me banorë të komunave Zerqan dhe Fushë-Bulqizë, për izolimin e këtyre zjarreve, që ata të mos prekin pikën e Liqenit të Zi.

Banorët e Dibrës thonë se një situatë e tillë ku zjarret

kanë shpërthyer në të gjitha ekonomitë pyjore të këtij qarku nuk është parë asnjëherë prej shtatëmbëdhjetë vitesh... Burime nga prefektura pohojnë se vetëm në rrethin e Dibrës gjatë kësaj periudhe ka pasur 11 vatra zjarri, 6 prej të cilave janë izoluar, ndërsa 3 vatra në malet e Lurës dhe një në malin e lartë të Korabit vazhdojnë të mbeten ende tepër aktive. Në Lurë, përhapja e mëtejshme e zjarreve mund të rrezikojë pikën turistike të liqeneve të Lurës. Më e vështirë paraqitet situata aktuale në malin e Korabit, pasi vatra e zjarrit, sipas specialistëve të pyjeve është shumë e rrezikshme dhe tepër aktive, ndër-



foto: b.k.

sa vetë terreni është tepër i thyer, ku nuk ekziston asnjë rrugë automobilistike.

Prefekti i Dibrës, Xhafer Seiti thotë se janë djegur mbi 100

hektarë pyje deri më tani, ndërsa shton se situata nuk është aspak nën kontroll. Po kaq alarmante është situata e zjarreve edhe në Bulqizë e Mat.

25 QERSHOR 2007

Pas 25 ditë protestash të vazhdueshme, 21 minatorë të Bulqizës janë ngujuar në grevë urie në mjediset e një ish-lokali të mbyllur, në qendër të qytetit. Kushtet e mjedisit ku po zhvillohet kjo grevë, janë të këqija, pasi ambienti është i vogël, grevistët janë të ulur në çimento, një banjo e vogël, e cila s'ka ujë për momentin. Policia ka marrë në dorë ruajtjen e mjedisit ku janë ngujuar minatorët dhe nuk ka lejuar askënd të takohet me ta. Të vetmet që kanë hyrë në këto mjedise, kanë qenë mediat, madje edhe ato jo të gjitha, por të preferuarat nga grevistët. Grevistët nuk janë vizituar nga asnjë mjek, por në orët e mesditës një infermier i spitalit të qytetit është përpjekur të kontaktojë me ta, por nuk është lejuar nga policia, pasi nuk ka qenë i pajisur me autorizimin përkatës të spitalit për këtë punë.

26 QERSHOR 2007

Deputeti i Partisë Republikane për Bulqizën, Genci Sharku, u u takua me grevistët. Ai ka garantuar minatorët, se Kryeministri Berisha do të njihej me kërkesat e minatorëve. Deputeti është përpjekur të sqarojë se deri më tani është vënë në rrugën e zgjidhjes me firmën e huaj, nënshkrimi i kontratës së punës, pagimi i sigurimeve shoqërore, si dhe kryesorja është kërkuar siguria në punë e minatorëve dhe realizimi i investimeve në masën 2 milionë euro, për makineri e pajisje, si elektrovoza me bateri, traversa, vagonë etj. Temperaturat e larta kanë shkaktuar marrje mendsh dhe luhajtje tensioni të disa prej tyre.

28 QERSHOR 2006

Përkeqësohet gjendja shëndetësore e 21 minatorëve. Në ditën e katërt të kësaj greve, njëri nga grevistët, Dëfrim Daci, 42 vjeç, i cili prej 20 vjetësh punon në këtë minierë, ka përfunduar në spitalin e qytetit, pasi gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar së tepërmi. Kryetari i bashkisë së qytetit, Roland Keta, ka bërë një deklaratë në TV lokal të këtij qyteti, ku shpreh shqetësimin për gjendjen e rënduar shëndetësore të minatorëve të ngujuar në këtë grevë, nisur edhe nga profesioni i tij si mjek, ju ka bërë thirrje atyre që të mos sakrifikojnë gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre, për zgjidhjen e problemeve që ata kanë, por t'i rikthehen dialogut, tolerancës, mirëkuptimit.

1 KORRIK 2007

Një tjetër minator i minierës së kromit në Bulqizë është detyruar të braktisë grevën e urisë, pasi gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar shumë, duke i vënë në rrezik edhe

PJESA II / KRONIKË E NJË GREVETË PARALAJMËRUAR

Fillon puna në minierën e Bulqizës



foto: b.k.

jetën. Mjekët vendosen të nxjerrin nga greva e urisë Bajram Dukën. Minatori 39-vjeçar kishte shfaqur shenja të përkeqësimit të shëndetit prej disa ditësh dhe ishte trajtuar në vijimësi me serume. Tre grevistët e urisë të shtruar në spital janë zëvendësuar në grevë nga minatorë të tjerë, duke e lënë të pandryshuar numrin e 21 të të ngujuar. Një grup njerëzish të mbledhur për të protestuar kundër qeverisë dhe firmës së huaj që administrojnë minierën e kromit. Në këtë tubim, minatorë dhe qytetarë të ndryshëm të Bulqizës kërkuar dorëheqjen e ministrit të Ekonomisë, Genc Ruli.

2 KORRIK 2007

Përshkallëzohet protesta e minatorëve të Bulqizës, duke përfshirë dhe familjarët e tyre. Në paraditen e të hënës, rreth orës 10:00, ka nisur në sheshin e qytetit të Bulqizës, para ambientit ku qëndrojnë të ngujuar prej 8 ditësh 21 minatorë të grevës së urisë, ka nisur një manifestim proteste i radhës, ku kanë marrë pjesë qindra minatorë dhe qytetarë të këtij qyteti, si dhe përfaqësues të sindikatave të metalurgëve në Burrel dhe Elbasan. Nisja e këtij tubimi proteste ka përkruar me ardhjen e kryetarit të grevës së minatorëve, Dilaver Përkoxha, i cili në orët e vona të ditës së diel, u shoqërua në ambientet e komisarariatit të policisë, pasi i drejtoi manifestuesit jashtë itinerarit të miratuar nga ana e kësaj policie. Protesta konfirmoi vendosmërinë e palëkundur të minatorëve, në mbrojtje të të drejtave të tyre, qoftë edhe duke

sakrifikuar gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre. Bilokimi i rrugës nacionale Tiranë-Peshkopi, i lajmëruar për ditën e sotme, pas dështimit të bisedimeve me ministrin Ruli, është shtyrë në një afat tjetër, pasi nesër minatorët protestues do të marshojnë për në Tiranë, ku së bashku me metalurgët e Burrelit dhe Elbasanit, do të protestojnë para Kryeministrisë, nën drejtimin e Konfederatës Sindikaliste dhe lëvizjes "Mjaft".

3 KORRIK 2007

Qindra minatorë të Bulqizës kanë vendosur shtrojet e tyre mbi barin e lulishës pas Muzeut Historik Kombëtar mbrëmë, ndërsa sot, të bashkuar me të tjerë, do të drejtohen për të bllokuar hyrjen kryesore të Kuvendit të Shqipërisë. Qëllimi: Të vështirësojnë pazarin politik të dy partive në zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës. Në fakt, kriza politike dhe një President i ri, apo ky që është, nuk hyjnë shumë në punë, kur jetët e njerëzve shuhën, ndërsa askush nuk reagon. Ky është motivi i protestës së nesërme të qindra minatorëve, të cilët duket se kanë vendosur të mos largohen nga Tirana pa marrë një përgjigje nga qeveria shqiptare mbi mjerimin dhe harresën që prej kohësh i ka kapluar. Një ditë më parë, me mbështetjen e lëvizjes "Mjaft" ata derdhën kova me bojë të kuqe para Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në shenjë proteste për heshtjen ndaj gjakut të vëllezërve të tyre, vetëm pak kohë më parë, nga përdorimi i fitilit skarco nga administrata e shoqërisë austriako-ruse, DARFO. Më pas, minatorët

iu drejtuan Kryeministrisë, ku sigurisht nuk mundi të kontaktonte as Kryeministrin e vendit. Rreth 200 minatorë të Bulqizës protestuan dje, për herë të parë në Tiranë, ndërkohë që greva e urisë e nisur 7 ditë më parë, vazhdon akoma në kushte tejet të rrezikshme për shëndetin e grevistëve. Pas protestës, një përfaqësi e tyre, së bashku me aktivistë të lëvizjes "Mjaft" dhe presidentit të Konfederatës së Sindikatave të Pavarura, Kolë Nikolla, zhvilluan një konferencë për shtyp, ku deklaruan se "nëse asnjë prej politikanëve nuk do të ketë vullnetin e duhur për të dëgjuar kërkesat legjitime të mbi 600 minatorëve, atëherë disa qindra prej tyre do të mblidhen përpara Kuvendit të Shqipërisë dhe do të pengojnë me të gjitha mënyrat paqësore zgjedhjen e Presidentit të ri". "Kujtojmë se janë minatorët e Bulqizës, të cilët kanë qenë ndër të parët qytetarë të këtij vendi që kanë protestuar 17 vjet më parë kundër komunizmit dhe skllavërimit, e duke kërkuar demokraci. Janë po aq të vendosur edhe sot, në vitin 2007, për të realizuar ëndrrën e një jete më të mirë, të një jete dinjitoze me kushte pune të përshtatshme për mijëvjeçarin e ri, e jo si ato në shekullin e 12", tha Elisa Spiropali, përfaqësuese e "Mjaft".

Minatorët kanë protestuar edhe para Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, ku dyert kanë qenë gjithashtu, të mbyllura. "Është e papranueshme, që ndërsa minatorët po rrezikojnë jetën, ministrat Genc Ruli dhe Kosta Barka, të cilët duhet të ishin ndërmjetës në negociatat me tyre dhe firmës koncensionare, heshtin dhe nuk bëjnë asgjë", tha një përfaqësuese e lëvizjes "Mjaft".

4 KORRIK 2007

Dita e dytë e protestës së minatorëve në kryeqytet u mbyll me një kampim të improvizuar me çadra fushimi përballë Kuvendit të Shqipërisë. Minatorët u vendosën aty në shenjë proteste ndaj indiferencës së qeverisë e politikanëve, ndaj mjerimit të tyre, duke qenë të vendosur të qëndrojnë aty pa afat. I njoftuar më parë mbi planin e minatorëve për të çarë gardhin e bluve, ndoshta me qëllim linçimin e tij, Genc Ruli, ministri i Ekonomisë zgjodhi një rrugë dytësore për të hyrë në sallën e Kuvendit. Lëvizja "Mjaft!" instaloi në sheshin përpara Kuvendit disa çadra dhe po i ndihmon ata edhe me ushqime. Policia u përpoq të ndalonte vendosjen e çadrave, duke pretenduar se ato ishin pa leje. Gjithashtu, ushqime kanë sjellë edhe qytetarë të ndryshëm, të cilët janë sensibilizuar nga gjendja e rëndë e minatorëve.

(Vijon në faqen 11)

**KËSHILLI
BOTUES
I GAZETËS**

Drejtor: **RAKIP SULI**. Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**.
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,**
ADRESA E GAZETËS: **Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.**
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Me datë 8-6-2007 në sallën e shfaqjeve të Pallatit të Kulturës u organizua një ceremoni me rastin e dhënies së titujve të nderit nga Këshilli i Qarkut Dibrë dhe Këshilli Bashkiak Peshkopi për zotërinjtë Munir Shehu, Rexhep Doda e Ulvi Shehu.

Merrnin pjesë deputeti i Dibrës z. Rahim Kaleci, kryetari i Bashkisë z. Ilir Krosi, këshilltarë të Qarkut, të Bashkisë etj. Ceremonia u zhvillua në formën e një spektakli ku fjala poetike, filmi dhe kolona muzikore krijuan emocione të veçanta për të pranishmit në sallë. Më pas në emër të këshillit të qarkut, z. Rexhep Hoxha i dorëzoi familjes së të ndjerit Munir Shehu, titullin "Nderi i Qarkut". Z. Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë Peshkopi, i dorëzoi z. Rexhep Doda titullin "Qytetar Nderi" ndërsa z. Premtim Kryemadhi, kryetar i Këshillit Bashkiak i dha titullin "Qytetar Nderi", z. Ulvi Shehu. Pas ceremonisë të pranishmit morën pjesë në shkollimin e bibliotekës së Përkullës së Mesme Profesionale.

CEREMONIA

Historia e qytetit tone nuk ka filluar me 1991. As me

"Tre shembuj qytetarie"

Munir Shehu, Rexhep Doda e Ulvi Shehu nderohet me titullin "Qytetar Nderi" nga Këshilli i Qarkut të Dibrës dhe Bashkia e Peshkopisë

1944, as me 1912. Ajo është e hershme, Ajo daton diku aty nga fillimet e shek XII

Sidomos ne shek XX Peshkopia edhe për arsye të ndryshme historike u formësua si një qytet i vogël e ne rritje. Dhe ajo nuk do të cilësohej qytet, pa zhvillimet urbanistike, pa art kulture muzike, pa biblioteke. Te tria këto komponente qytetare kane protagonistet e tyre: nder te cilët Rexhep DODA, Munir SHEHU, Ulvi SHEHU.

Kujtesa qytetare do te ishte e cunguar po te mos skaliste ne piedestal emrat e qytetareve qe lanë gjurme ne jetën e një qyteti e me gjere . Tre emra, Tre njerëz, Tre personalitete. Ata nuk e dinin se me jetën e veprën e tyre dekada me vone, bashkëkohësit dhe jo bashkëkohësit e tyre, te njohurit e te panjohurit, një qytet i tere . Njëpërmjet përfaqësuesve te tij, do ti transformonte ne përmendore adhurimi e respekti qytetar.

Munir Shehu, babai i këngës së kultivuar dibrane

Përgjatë konflikteve të mëdha, të hapura të fshehura, e shpesh të pleksura përvijohen personalitete e figura që lënë gjurmë në histori. Gjurmët në fushën e artit, letërsisë, muzikës, përgjithësisht janë shumë dimensionale dhe nuk shuhet lehtë. Kështu emri i Munir Shehut, kujtohet me shumë përtribute në fushën e muzikës, pa u ndalur në ato të arsimit, historisë etj.

Muniri vinte nga një familje, e cila, pa mëdyshje mund të themi se që nga fillimet e shekullit XVII, por në mënyrë të veçantë në shekullin XX i dha tonin jetës politike, kulture dhe ekonomike të qytetit të Peshkopisë.

Muniri i takoi asaj plejade që, pasi përfundoi Normalen e Elbasanit, iu përkushtua përhapjes së arsimit nëpër viset shqiptare. Në mënyrë të veçantë spikati si krijues muzike, drejtues dhe mësues i saj. Intelektuali dhe artisti i ri nuk mund të pajtohej me totalitarizmin, primitivizmin dhe egërsinë e regjimit enverist. Për këtë ai arrestohet dhe dënohet të vuajë kaluarin e burgjeve komuniste, në të cilat një sëmundje vdekje – prurëse për pak i mori jetën.

Ndonëse në kushte të rënda të dhunës më çnjerëzore që kish njohur shoqëria e deri atëherëshme, atij nuk iu zbeh pasioni për muzikën. Përkundrazi në qelitë e ftohta e të errëta të diktaturës, Muniri, kompozoi një këngë apo teozë për lirinë, që u kthye në himn për të gjithë të burgosurit e Shqipërisë, dhe që u përhap me shpejtësi anë e mbanë vendit duke i

shpjeguar me mjete artistike njerëzore, për vuajtjet, torturat e mundimet e të burgosurve dhe andrrat e tyre për lirinë.

Pas lirimit nga burgu, në gjysmën e dytë të viteve '50, Muniri i përkushtohet tërësisht muzikës. Fillon punë si orkestrant (në fakt bënte punën e drejtuesit të orkestrës) në Shtëpinë e Kulturës Peshkopi. Në ato vite rishpërthen talenti i tij duke kompozuar këngë qytetare dibrane, suita, pjesë për violinë e orkestër etj.

Ai mund të quhet pa dyshim si babai e themeluesi i këngës së kultivuar dibrane. Jo vetëm kaq, por edhe orkestrës së Shtëpisë së Kulturës iu dha timbrin modern e tingëllimin artistik ku tradita shqiptare, klasika dhe modernia shkriheshin në një të vetme.

Me ardhjen e Munirit filluan të përhapeshin tingujt e Moxartit, Shopenit, Verdit, Belinit duke sjellë në qytet muzikë, freski e poezi. Bashkë me intelektualë të tjerë të qytetit po konsolidonin frymën e një qyteti ardashës, të pastër e ambicioz. Muniri traso i rrugën për zhvillimet e mëtejshme cilësore në fushën e artit e të muzikës që do të kulmonin më vonë me ngritjen e estradës, teatrit, ansambllit, bibliotekës etj. Muniri nëpërmjet veprimtarisë së tij krijuese e përpunuese forcoi më tej karakterin qytetar të muzikës dibrane, rriti ndjeshëm nivelin artistik të orkestrimit dhe interpretimit duke ndikuar së tepërmi bashkë me pasardhësit në futjen e muzikës dibrane në repertorin më të kërkuar të kohës.



Rexhep Doda, simboli i ndryshimit të Peshkopisë

Rexhep DODA, përfaqësues i një familjeje me tradita të mirëfillta atdhetare, me kontribute të qenësishme në luftërat kundër turqve, serbëve, pushtuesve nazifashistë.

Qe ne moshe te re do te shpaloste virtytet me te mira te familjes se tij ne luftën çlirimtare kundër pushtuesve.

I edukuar ne një familje te njohur ne gjithë Dibrën për krenarinë, besën, mikpritjen e trimërinë, Rexhepi do te rradhitej me forcat përparimtare demokratike, ne përpjekje për ta çliruar e ndryshuar Shqipërinë.

Endrrat e tij për një Shqipëri të lirë e demokratike, ashtu si dhe te shume shokëve te tij, u thyen dhe u këputën keqas nga vendosja e regjimi nga me barbarete dhe me represive ne historinë e njerëzimit.

Këtu fillon dhe drama e Rexhep DODES. Personaliteti i tij do te rritej nëpërmjet dilemave dhe konflikteve te brendshme nga njëra ane dëshira për te dhënë gjithçka për lirinë e ndërtimin e vëndit, humanizmi, respekti për te rënë, për te mirën, adhurimi për te bukurën, për këto kategori estetike me vlera universale dhe nga ana tjetër presioni i diktaturës, i urrejtjes krahinore, mediokriteti qe ushtrohej pa reshtur nga regjimi i kohës, ndikoni ne mënyrë te pashmangshme dhe paracaktonin deri diku fatin e luftëtarit te paepur, intelektualit te shquar dhe vizionarit te guximshëm, z. Rexhep DODA.

Rexhepi dhe Peshkopia u projektuan si një simbioze qe reflektonte përpjekjet për tu rilindur, për tu zhvilluar, për tu ndryshuar. Një hotel turizmi i mrekullueshëm dhe i rrallë për kohen, një shtëpi kulture funksionale, stadiumi, shkollat e mesme, bulevardet, parqet, ur-



banizimi, sporti, kultura, janë emblemat e kohës ku ndrit pasioni guximi, korrektësia, imagjinata e fantazia a Rexhep DODES.

Rexhepi e Peshkopia një simbiozë ku tradita e mikpritjes, mbajtjes se fjalës së dhënë, aspirata për ndryshim, gërshetoheshin me afirmimin e së resë, bashkëkohësisë dhe progresives e mbi te gjitha afirmimin e se bukures.

Kështu Peshkopia jone ne ato vite u zhvillua cilësisht ndryshe nga simotrat e saj. Nuk është e rastit qe ne Peshkopi thitheshin ELITA nga te gjitha fushat. Dhe për këtë Peshkopia falënderon z. Rexhep DODA.

Nderimi për zotin Rexhep, kur kujtojmë kushtet ne te cilat AI u përpoq për një Peshkopi te re, kushte qe shpesh përfutuan pamje dramash a skenash tragjike, rritet ndjeshëm e sot ne kohen e lirisë e te demokracisë fiton dimensione reale.

Pas ndryshimeve demokratike zoti Rexhep përjetoi çlirimin e dytë dhe te vërtetë. Ndonëse ne moshe te thyer AI me guxim u rreshtua me forcat demokratike duke dëshmuar se andrrat për liri e demokraci mund te fashiten përkohësisht, por s'mund te shuhet kurrë.

Ulvi Shehu, model i papërsëritshëm i humanizmit

Qytetarët e Peshkopisë, Dibrës e më gjerë kanë ndjerë për së afërimi kontributet e Ulviut në zhvillimin e Kulturës në përgjithësi e asaj të librit në veçanti. Në ato kohëra të vështira me një pasion të çuditshëm ai bashkë me kolegë të tjerë të Shtëpisë së Kulturës ku ai shërbente si regjisor, aktor, organizator etj. S'lodhej së shkuari në çdo fshat të Dibrës. Për të qetësuar sadopak shpirtrat e lodhur nga uria.

Ulvi Shehu, modeli i qytetarit të kulturuar e të pasionuar skajshëm për punën kishte merituar respektin e qytetarëve të Peshkopisë e Dibrës, të njerëzve të artit e kulturës, të administratës. Me pasionin e një shkencëtari për librin e transformoi bibliotekën në një institucion shkencor por edhe më tepër se kaq. Në kushtet e izolimit total të errësirës mesjetare të territ informativ ai me zellin e tij të pashtershëm abonohej dhe sillte në Peshkopi gazeta, revista, botime, enciklopedi që i shërbenin elitës dibrane për të çarë errësirën e për të parë dritë në fundin e tunelit. Duke i shpëtuar shpesh censurës Komuniste Ulviu, nëpërmjet veprave kulturore, shkencore, publicistike, mjekësore, arkitekturore, edukonte gjenerata të tëra për të dalë nga rrethi vicioz ku i kishin zhytur, për të dalë jashtë skemave, klisheve e standarteve të ideologjisë komuniste. Sikur vetëm kjo tendencë, kjo veprimtari shpesh e kamufluar do të mjaftonte për të falënderuar Ulviun tonë të dashur që sot ndodhet këtu mes nesh.

Në ato kohëra kur asgjësohej çdo frymë lirie, çdo mendje ndryshe, çdo traditë që binte ndesh me obskurantizmin e kohës, në sallën e rezervuar të bibliotekës gjeje çdo gjë. Dhe aty depërtonin intelektualët dibrane për të gjetur prehje, për të gjetur dritë, për të marrë pak frymë lirisht, për të gjetur pakëz nga liria e munguar.

Skedari krahinor ishte një kontribut absolutisht ekskluziv i Ulviut. Aty pasqyrohej fondi i kulturës dibrane në shekuj, i paseleksionuar nga absurdi i ideologjisë së klasës punëtore. Aty gjendej ekstrakti i letërsisë, politikës, gazetarisë dibrane, i qëmtuar me dashurinë, kujdesin e mundin e një blete punëtore.



Tek Ulviu janë harmonizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, njeriu me profesionistin, njeriu me artistin, njeriu me administratorin e përkryer. Gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë u kthye në një model të papërsëritshëm ku humanizmi shkrihej si në një pikë të vetme me ndjenjën e përgjegjësisë dhe kryerjes së detyrës. Me keqardhje sot figura të tilla janë të rralla.

Të tria personalitetet që po nderojmë sot punuan në kushtet e një sistemi tjetër. Merita e tyre ishte se ditën të krijojnë vlera në situata të vështira e të rënda.

Qytetarët respektojnë sakrificat, përkushtimin për detyrën, ndershmërinë e korrektësinë. Sot kur po japim këto tituj nderi njëkohësisht ne konstatojmë se kemi shumë nevojë për ripërtëritjen e vlerave të mësipërme. Parë në këtë vështrim duke u përpjekur të abstragojmë drejt dukurive, këto tituj nderi shërbejnë njëkohësisht si përmendore adhurimi për vlerat qytetëruese dhe emancipuese të përkushtimit ndaj punës, të respektit ndaj qytetarëve, të shpirtit të lartë të sakrificës e profesionalizmit të dukshëm.

Zotërinjtë që po dekorohen e që janë në këtë sallë i falënderojmë për atë që kanë bërë për qytetin, për trashëgiminë e vyer që na kanë lënë, për modelin e njeriut punëtor e fisnik që kanë krijuar.

Përgatiti: Lavderim Shehu

Kërkohet një Komision i Përhershëm për ndërtimin e Rrugës së Arbërit

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**
Ambasador

Muajin e shkuar Kryesia e Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë dhe disa organizata të tjera dibrane organizuan në hotel "Tirana" një Kuvend Tekniko-Shkencor kushtuar domosdoshmërisë së ndërtimit të Rrugës së Arbërit, që do të shkurtonte distancën aktuale Tiranë-Peshkopi me rreth 100 kilometra.

Mbajtja e këtij kuvendi ishte një nismë e lavdërueshme për sensibilizimin e opinionit publik lidhur me rëndësinë e madhe që merr ndërtimi i kësaj rruge në të gjitha aspektet: shoqërore, ekonomike, politike e deri strategjike. Por, pavarësisht nga kjo, mendoj se Kuvendi, ndërsa realizoi deri diku mirë misionin propagandistik, nuk bëri ndonjë gjë konkrete në drejtimin organizativ, dmth., për marrjen e masave organizative, tepër të domosdoshme, për vënien në jetë të këtij projekti jetësor për Dibrën në të dyja anët e kufirit. Këtë të vërtetë e cekën në kumtesat dhe diskutimet e tyre disa referues e folës, por ndoshta organizatorët ose nuk e kishin planifikuar një gjë të tillë, ose nuk deshën të zgjatëshin më tej për efekt të kohës në dispozicion.

Me thënë të drejtën e kam ndjekur problemin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit prej shumë kohësh dhe mendoj se, pavarësisht nga disa hapa që janë bërë deri tani, si studimi i fizibilitetit apo vendimi i qeverisë për ta vënë atë në prioritetet e saj ndërtimore, nuk është bërë ndonjë gjë e madhe që të mund të na qetësonte se ndërtimi i saj është vënë në binarët e duhur. Unë bashkohem me mendimin se duhet të ishte ngritur patjetër një komision i posaçëm me specialistë inxhiniero-teknikë, me politikanë, biznesmenë, ekonomistë etj. Komisioni, nëse do të

krijohet, duhet të ndiqte në vazhdimësi çështjen e ndërtimit të rrugës, duke u mbledhur herë pas here e duke analizuar e marrë hapa që do t'i shikonte të nevojshëm për të çuar punën përpara. E para që mund të bënte ky komision mendoj se mund të ishte studimi i rrugëve për gjetjen e fondeve të nevojshëm, sepse, po nuk u siguroan fondet, mund të organizohen me dhjetëra kuvende sensibilizuese dhe të mbetesh në vend, siç edhe ka ndodhur.

Në duhet të hidhemi nga fjalët në vepra. Komisioni, nëse do të ngrihet dhe duhet të ngrihet, duhet të dalë me detyra konkrete si për vete në përgjithësi ashtu dhe për anëtarë të veçantë të tij apo edhe për persona që mund të japin ndihmesën e tyre për ndërtimin e rrugës. Ai duhet të përcaktojë se në ç'mënyrë do të ndërtohet rruga: do të sigurohen fondet nga buxheti i shteti, do të merret ndonjë kredi apo do të jepet me koncesion. Nëse do ta ndërtonte shteti me fondet e buxhetit të vet, do të na lehtësohej më shumë puna. Ndryshe, çështja komplikohet dhe detyrat e komisionit bëhen më të mëdha e më me përgjegjësi. Atij do t'i duhet të mendojë për gjetjen e ndonjë kreditori, i cili ndoshta kërkon garanci nga shteti shqiptar. A do t'i jepte këto garanci shteti ynë? Po koncesioneri kush do jetë dhe ç'kushte na ve? Po në rast se këto drejtime nuk japin rezultate, ku të përplasemi? Do shpallim një hua popullore dhe, në rast se po, kush do ta administrojë dhe si do t'u kthehet ajo huadhënësve? Pra janë një sërë problemesh që mund t'i zgjidhë vetëm komisioni i ngritur enkas për këtë problem madhor për dibranët.

Natyrisht, komisioni mund të ngrejë edhe grupe pune të posaçëm për probleme të veçanta, duke vënë detyra konkrete për secilin sipas përparësive.

Nëse sot përparësi është përgatitja e projektit, atëherë mund të krijohet grupi që do të punojë për përgatitjen e projektit. Por një grup mund të krijohet edhe për mbajtjen e lidhjeve me qeverinë, një për gjetjen e fondeve etj.

Një aspekt tjetër, që mendoj se duhet të kihet parasysh për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, është jo vetëm sensibilizimi i dibranëve në Tiranë, por kryesisht i atyre në Dibër dhe zonat nga do të kalojë rruga. Ky sensibilizim duhet t'i shërbejë presionit mbarëdibran ndaj autoritetit të shtetit dhe atyre që përçojnë politikën shtetërore nga poshtë lartë dhe anasjelltas. Puna është që shtetarët të angazhohen sinqerisht për ndërtimin e rrugës, duke na dhënë edhe një afat. Të gjithë e mbajmë mend se si z. Fatos Nano "inauguroi" fillimin e punimeve për ndërtimin e saj në vitin 2005, duke bërë një reklamë të gjerë në organet e medias. Thuhet se edhe qeveria e z. Berisha vitin e kaluar kishte caktuar një fond prej 10 milionë dollarësh për ndërtimin e segmentit Bllatë-Bulqizë, por se ku vajtën këto para nuk e dimë dhe siç duket as për ta marrë vesh kemi.

Tani qeveria e z. Berisha sapo deklaroi rishitazi se ka caktuar një fond të ri për segmentin e cituar më lart. Të shpresojmë se këtë radhë fjalët do të kthehen në veprime konkrete.

Në i kuptojmë problemet madhore që ka vendi në përgjithësi, por kuptojmë gjithashtu se ndërtimi i Rrugës së Arbërit nuk është më pak madhor. Ajo, përveç krahinës së Dibrës në të dyja anët e kufirit, do t'i shërbejë mbarë vendit e në radhë të parë Shqipërisë së Mesme dhe Veriore, pasi do të lidhë Durrësin e Shkupin e më tej shumë më shpejt se sa rruga aktuale që kalon nga Qafëthana. Nëse Qeveria çdo vit do merrte përsipër ndërtimin e një segmenti

të caktuar 15-20 kilometra, rruga do mbaronte për 5-6 vjet. Kjo mënyrë nuk do ta rëndonte shumë arkën e shtetit, por do të përfundonte edhe veprën.

Me një fjalë, ne nuk kemi nevojë për fjalë të mira e gurë në trastë. Ne duam ndërtimin e rrugës. Prandaj sensibilizimi i dibranëve kudo ku janë, por sidomos në bazë, atje ku jepen e numërohen votat, është me shumë rëndësi. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se po nuk qau fëmija, nuk i jep gjë e ëma. Dibranët nuk duhet të lënë rast pa paraqitur kërkesat e tyre për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Sa herë që në Dibër të shkelë ndonjë qeveritar, sidomos nga ata që kanë në dorë, banorët e Peshkopisë të dalin në rrugë me pankarta e të organizojnë mitingje me kërkesë ndërtimin e rrugës që do të jetë shpëtim nga gjendja aktuale ku është katandisur qyteti dhe krahina. Ne duhet t'u tregojmë pushtetarëve se i kemi zgjedhur në postet që kanë që të na shërbejnë dhe jo mashtrojnë sa për të na marrë votën.

Siç shihet, fushat e punës së komisionit do të ishin të shumta dhe kërkojnë impenjim me përgjegjësi. Prandaj në të të zgjidhen njerëz që janë të gatshëm ta tërheqin plugun e jo kukulla, njerëz të përkushtuar e patriotë. Dhe të tillë nuk i kanë munguar dhe as do t'i mungojnë popullit trim, punëdashës e të kulturuar të Dibrës.

Në mënyrë të veçantë lind nevoja e ngritjes së më parë të këtij komisioni aktualisht, kur Shqipëria është listuar në tregjet financiare ndërkombëtare si vend i sigurt për investimet e huaja dhe kur, siç deklaroi z. Sali Berisha, vendit tonë i janë dhënë 400 milionë dollarë kredi për ndërtimin e infrastrukturës rurale. A nuk mundet që një pjesë e këtij fondi të shkojë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit? Duhet trokitur sa është hekuri i nxehtë!

Rruga e Arbërit, Skavica, Bulqiza dhe dyshimet e mia...

Nga **BUJAR KAROSHI**

Nuk kanë kaluar as dy muaj nga dita që u zhvillua në Tiranë Kuvendi Tekniko-Shkencor për Rrugën e Arbërit dhe duket se u ringjallën shpresat për fillimin e ndërtimit të saj. Deputetët dibranë në Parlamentin shqiptar, folën në atë kuvend para 300 burrave, duke e vënë theksin se qeveria nuk e ka anashkalluar si proces, por njëkohësisht duke vënë në dyshim edhe pjesë të studimit të fizibilitetit mbi Rrugën e Arbërit. Sali Shehu, deputeti i Bulqizës, tha se nga angazhimet e tij në Parlament dhe në qeveri kishte marrë premtimin nga kryeministri aktual, Sali Berisha, se fondet e para të ndërtimit të Rrugës së Arbërit do të jepeshin në vitin 2009, kohë kur pritet të përfundojë një nga rrugët me më rëndësi kombëtare aktualisht në vend, Rruga e Kukësit.

Por, nuk kaluan as dy muaj dhe si "një rrufe në qiell të hapur", kryeministri i vendit, z. Sali Berisha, në mbledhjen e qeverisë të datës 13 korrik 2007, duke folur për buxhetin shtesë të vitit 2007, theksoi se "Fondet e buxhetit suplementar do të përdoren për financimin e autostradës Durrës-Morinë, pjesa dërmuese e investimit, por do të përdoren edhe për dy akse të tjera rrugore, autostradën Korçë - Qafë-Pllocë dhe aksin Bllacë - Bulqizë, prej 17 kilometrash, Rruga e Arbërit". Më vonë, në diskutimet e këtij projektbuxheti shtesë në parlament, u fol se shuma e vënë në dispozicion për Rrugën e Arbërit ishte 18 milionë Euro.

Meqë ka shumë kohë që "Rruga e Arbërit" më del dhe në ëndërr, u gëzoja. Më shumë më gëzoi shifra prej 18 milionë eurosh, e mjaftueshme sipas meje, për të ndërtuar një rrugë të standardeve kombëtare. Por ajo që nuk më

pëlqeu në këtë fjalë, ishte përmendja e doganës së Bllacës. Jo vetëm unë, por çdokush që ka lexuar e dëgjuar për Rrugën e Arbërit, e di shumë mirë se ajo nuk del në Bllacë.

Ajo mund të shkelë në çdo vend tjetër nga Bulqiza në Tiranë, por në Bllacë jo. Sipas projektit të Studimit të Fizibilitetit, varianti i dytë, i miratuar dhe i firmosur nga Këshilli Kombëtar i Rrugëve, rruga në vendin e quajtur Ura e Cerencit ndryshon drejtim për nga fshati Gjoricë, sipas urës dhe rrugës ekzistuese deri në fund të fshatit, ku kalon lumin Drin, i cili përbën fundin e rrugës në pjesën shqiptare dhe takon pikën kufitare me Maqedoninë. Ndërsa në variantin e parë, të diskutuar në studimin e fizibilitetit, bëhet fjalë për pikën fundore në doganën e Bllatës.

Ajo që është shqetësuese për komunitetin në këtë proces është mungesa e informacionit.

A e di qeveria shqiptare variantin e miratuar të Rrugës së Arbërit?

A është qeveria shqiptare e ndërgjegjshme se Rruga e Arbërit është një nyje e rëndësishme kombëtare që i mungon këtij vendi?

A është e angazhuar qeveria shqiptare dhe institucionet përkatëse për vënien në zbatim të këtij projekti të madh kombëtar?

Sigurisht, jam i prirur të besoj se qeveria është e ndjeshme ndaj këtij procesi. Dhe, ndoshta, ata që merren me përgatitjen e dokumentacionit për këtë problem, nisen nga dokumente e botime paraprake, pa marrë parasysh atë që është firmosur në Këshillin Kombëtar të Rrugëve nga ish-kryeministri Fatos Nano, në korrik 2004.

Ajo që më shton dyshimet e mia për jo seriozitetin në këtë proces është se, pikërisht me 13 korrik, minatorët e Bulqizës iu rikthyen një greve njëorëshe.

Po ta shohësh më gjerë, tre gjërat me rëndësi kombëtare që zotëron Dibra (tre gjërat të diskutuara sot, se Dibra ka shumë) nuk janë marrë seriozisht asnjëherë nga qeveria që e ka drejtuar këtë vend në 17 vitet e fundit.

E para është miniera e Bulqizës, këtë pasuri kombëtare që qeveria ua ka falur firmave fantazmë që s'dihet nga vijnë e çfarë bëjnë në këtë qytet të përvuajtur.

Akoma kësaj dite nuk është bërë publike një kontratë e qeverisë shqiptare me koncensionarin që shfrytëzon minierën. Jo më të bëhet fjalë për bërjen publike të kontrolleve qeveritare apo institucioneve të tjera, të cilat prej kohësh e kanë nxjerrë koncensionarin me shkelje ligjore, duke mos realizuar investimet e premtuara, por vetëm duke shfrytëzuar në maksimum njerëzit dhe nëntokën e këtij qyteti. Vetëm kur del në pah kriza, si ajo e grevës apo ndonjë debat shterp në parlament, përmenden shifra si: "x" milionë investime e "x" milionë për sigurinë, por asnjëherë se kur këto firma duhet të vihen përpara përgjegjësisë për mosrealizimin e asaj që kanë nënshkruar në kontratë. Por kur s'ka kontratë të njohur publikisht, natyrisht nuk ka edhe përgjegjësi. Faji për varfërinë që ka mbuluar qytetin e ngritur mbi pasurinë mbetet gjithmonë jetim.

Së dyti, sjellim shembullin e Hidrocentralit të Skavicës. Sa herë vendi zhytet në krizë energjetike, specialistët të fushës ia hedhin fajin mungesës së investimeve, duke argumentuar se në këto 17 vjet nuk kemi ndërtuar asnjë hidrocentral, asnjë termocentral apo ndonjë burim tjetër energjie, nuk kemi ndërtuar Skavicën e planifikuar që në vitin 1980, etj. Madje, edhe ato firma që ofrohen për ta ndërtuar në prag të këtyre krizave, ose janë të dyshimta në arenën ndërkombëtare, ose qeveria sh-

qiptare nuk bën asnjë përpjekje serioze për të afruar investitorë seriozë në këtë fushë. Jo më të bëhet fjalë për projekte zhvillimi e ndërtimi, për të mbyllur ciklin e hidrocentraleve mbi Drin, sipas një projekti kaskadë. Kam dyshimet e mia, se në një moment krize që do thellohet më shumë në ditë që vijnë, një "koncensionar" si ai i minierës së Bulqizës do të shfaqet në horizont, duke përmbatur Dibrën dhe duke shtuar një qytet tjetër në varfëri.

Së treti, investimet gjysmake, këtë radhë nga Qeveria për Rrugën e Arbërit, më shtojnë dyshimet se për Dibrën e më gjerë nuk ka projekte serioze. Investimet gjysmake në Rrugën e Arbërit nuk do të na çojnë askund. Nuk do të kemi kurrë Rrugën e Arbërit të ëndërruar e të kërkuar. Do të kemi vetëm një rikonstrukcion sa për të na hedhur hi syve, sa për të na thënë se kishit një rrugë që shkon mospërmasë veriu të Shqipërisë për në Dibër, dikur me gropë, tani e asfaltuar.

Premtime të tilla për ndërtimin e zhvillimin në Dibër nuk i shërbejnë asaj dhe nuk janë për integrimin e rajonit. Projektet gjysmake të shfrytëzimit të minierës së Bulqizës kanë vërtetuar sot e kësaj dite se Bulqiza është zhytur vetëm në varfëri, projektet gjysmake dhe jo serioze kanë vërtetuar gjithashtu se Skavica nuk do ndërtohet, aq më keq nëse ndërtohet nga firma ndërkombëtarisht të dyshimta dhe, realizimi i projekteve gjysmake për Rrugën e Arbërit do të çojnë në mosndërtimin e saj sipas standardeve ndërkombëtare, por një realizim i cunguar i saj, që s'do të bëjë gjë tjetër veç do mbajë Dibrën të pa integruar e të pa zhvilluar, si deri më sot.

Ndoshta shumë prej lexuesve nuk do jenë dakord me dyshimet e mia. Unë bashkohem me ta: Qofsha i gabuar!

RRUGA E ARBËRIT

dhe ndërtimi i autostradave në Maqedoninë Veriperëndimore dhe lidhshmëria me Kosovën

Nga Ing. SHEFKI ALITI*

Projektimi dhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit tërësisht bazohet në strukturën dhe spektrin e nevojave bashkëkohore të zhvillimit permanent ekonomik e infrastruktura. Përputhet me dinamikën e trendeve regjionale të Evropës Juglindore, Integriteteve euroatlantike, synim permanent i viteve që vijon për Shqipërinë dhe Maqedoninë veri-perëndimore e më gjerë për tërë regjionin ballkanik.

Instrukcionet që elaborohen më poshtë, përfshijnë tërë projektet për ndërtimin e autostradave si dhe ndërtimin e tyre që janë të lidhur ngushtë me domoshmërinë e zhvillimeve rrugore-infrastruktura të Republikës së Maqedonisë me theks të veçantë në pjesën veri-perëndimore të saj. Për me rëndësi për lidhshmërinë e ekonomive, të qyteteve, regjioneve ekonomike si dhe zhvillimet parimore në përgjithësi.

Lidhshmëria si nevojë për brenda, në ndërlidhje të qyteteve dhe regjioneve me autostradë bashkëkohore do të kontribuojë në zhvillim të shpejtë ekonomik, kulturor-gjeopolitik dhe bashkëpunim të ndërsjellë politik-ekonomik, ndër shtetet në mes vedit me qendra të fuqishme ekonomike, për kapacitete në zhvillim të tërësishtëm.

Në këtë kuptim, kemi arritur suksese duke projektuar një autostradë të emëruar "Koridori - 8C". Motivi inxhinierik për këtë projekt ka qenë konsiderata se ky "Koridor" është ëndrra 10-vjeçare e proceseve zhvillimore në këto transformime shoqërore.

Diplomacia e Maqedonisë, Shqipërisë dhe stafi i inxhinierëve të këtyre vendeve flet pothuaj se 10 vitet e fundit. Pse me perspektivat e tyre panevropiane, krahasuar me "Korridorin - 10" sot e kësaj dite është i dështuar "Koridori - 8".

Politika shqiptare, maqedone dhe ajo italiane ka rënë ndesh me kundërshtimin e politikës greke në kuadër të Bashkimit Evropian, e cila me të madhe mundohet të anashkalojë këtë korridor, duke favorizuar "Korridorin 10" që ndërlidh Athinë-Selanik-Shkup-Beograd. Disponojmë me të dhëna se Greqia edhe më tej tenton të ndalojë kreditë nga Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim (Berzh) për ndërtimin e këtij korridori ku ato kanë edhe funksionarë të lartë në bordet e Bankave Evropiane dhe botërore. "Koridori 8" fillon nga qyteti Varna i Bullgarisë deri në Durrës në një gjatësi prej 960 km. Për ndërtimin e këtij projekti janë paraparë të harxhohen rreth 2 miliardë Euro. Ky korridor kap një gjatësi prej 315 km brenda territorit të Maqedonisë dhe janë ndërtuar dhe përfunduar punimet për 85 km që janë në funksion ndërsa në momentin e tanishëm është duke u ndërtuar pjesa e "Korridorit 8" e ashtuquajtura Autostrada Qarkore e Shkupit me gjatësi 25 km, ku janë të përfunduara punimet afro 70% që do të thotë se "Korridorit-8" nga fundi i vitit 2008 brenda territorit të Maqedonisë do të jetë i ndërtuar vetëm 110 km. Pas përfundimit të ndërtimit të autostradës - qarkorja e Shkupit ngelin të pa ndërtuara edhe 205 km gjatësi për mbarimin e projektit të "Korridorit 8" të R. Maqedonisë. Ngelin të pa ndërtuara dy segmentet kyçe të "Korridorit 8" dhe atë pjesa prej kufirit Bullgaro-Maqedon-Kriva Pallanka dhe Kumanova dhe pjesa tjetër përtej kufirit Shqiptaro-Maqedon (Qafë-Thanë) - Strugë - Kërçovë deri në qytetin e Gostivarit. Këta dy

segmente të pandërtuara të "Korridorit 8", nga aspektet ekonomiko-gjeografike dhe tekniko-shkencore, janë të parealizueshëm, veçanërisht segmenti Gostivar-Qafëthanë. Ky segment i "Korridorit 8" është paraparë të ndërtohet paralel me autostradën ekzistuese që ndërlidh qytetet Gostivar-Kërçovë-Strugë-Qafëthanë. Shkatërron ambientin gjelbërimi, male, fusha etj. Kalon nëpër ambient shumë të vështirë për ndërtim, shumë tunele dhe ura dhe me një kosto ndërtimi të lartë dhe duke lënë jashtë përdorimit (inerte) autostradë ekzistuese shumë moderne. Në territorin e Shqipërisë nga Durrësi deri në Qafëthanë janë 176 km gjatë të "Korridorit 8".

Duke patur parasysh faktet e lartpërmendura dhe duke aprovuar eksperimentin dhe duke aprovuar eksperimentin dhe njohuritë inxhinierike shumëvjeçare kemi punuar dhe përfunduar projekte të përmbajtura në aspektin ekonomik dhe tekniko-shkencor.

1. Rruga e Arbërit

Është projektuar që traseja të fillojë nga kufiri Maqedoni-Shqipëri te vendi Gjorica e Epërme - Fusha e Bulqizës - mbi qytetin Bulqizë - Guri i bardhë - Muriza - Selita e Poshtme - Zallë Dajti - Tiranë.

Nga aspekti tekniko-shkencor projekti i autostradës Rruga e Arbërit, përmban këta parametra:

- Gjatësia: 64 km
- Gjerësia: 25.5 m

Nga aspekti i gjerësisë është projektuar që autostrada të jetë me dy drejtime me nga dy korsi të gjera me nga 3.5 m, me dy korsi ndihmëse nga 2.5 m me brez gjelbërimi për dy drejtimet nga 1.5 m ose gjithsej 3 m gjelbërim, si dhe janë paraparë bankina, elemente mbrojtëse etj.

- Ura: 2.460 m
- Tunele: 9.300 m
- Shpejtësia: 100 km/h
- Kostoja e ndërtimit afro 250 milionë Euro

Autostrada do të kalojë nëpër vend (pika) turistike ku do të ndërtohen objekte karburantesh, hotele dhe restorante, pushimore, shtëpia ëikendi etj.

Do të ringjallen gjitha vendbanimet për rreth autostradës.

Me ndërtimin e autostradës Rruga e Arbërit do të realizohet ndërlidhja me e shkurtër me vende turistike të R. Maqedonisë siç janë - me liqenin e Ohrit, të Dibrës dhe Mavrovës.

Me qytetet piktoreske Strugë dhe Ohër. Me qendrat turistike dimërore: Bistra, Mavrova dhe Kodra e Diellit në Tetovë.

Ndërlidhen qytetet Bulqizë-Peshkopi-Dibër e Madhe-Strugë-Kërçovë-Gostivar-Tetovë-Shkup dhe bëhet ndërlidhja në drejtim të Kosovës me qytete dhe fshatra siç vijon:

Gllaboçiq - Ferizaj - Kaçanik - Elsan - Lipjan - Viti - Gjilan - Prishtinë - Mitrovicë dhe ndërlidhje me Prizrenin që është e paraparë me autostradës e re me projektin e autostradës Tetovë-Prizren. Që të arrihet kjo ndërlidhje e shteteve, regjioneve dhe qyteteve kemi punuar projektet e autostradave të tjera siç janë.

2. Vazhdimi i autostradës Rruga e Arbërit me segmentin rrugor prej kufirit Shqipëri-Maqedoni deri tek



Pamje nga Mavrova

ura e Boshkut.

Gjatësia: 14.4 km
Gjerësia: 25.5 m
Ura: 520 m
Tunele: 400 m
Shpejtësia: 100 km/h
Kostoja e ndërtimit afro 44 milionë euro

3. Segmenti i autostradës Ura e Boshkut-Novosell (mbi Gostivar)

Gjatësia: 38.1 km
Gjerësia: 25.5 m
Ura dhe Vijadukte: 2482 m
Tunele: 3050 m
Shpejtësia: 100 km/h
Kostoja e ndërtimit afro: 137.500.000 euro

Kjo autostradë kalon në anën e majtë piktoresk të liqenit të Mavrovës në drejtim të vendeve Ura e Boshkut - Rosoi - Bistra - Mavrovë - Niqiforovë - Leunovë - Novo Sellë (mbi Gostivar).

Autostrada është paraparë të ndërtohet në një hapësirë shumë piktoreske ku mund të ndërtohen shumë qendra turistike dimërore, për pushim, skijim etj. Ky vend aq atraktiv i pashkelur dhe shumë interesant, hap dyert e investitorëve të huaj shumë të interesuar për ndërtim të autostradave, hoteleve turistike dhe njëkohësisht investitor të huja kanë interesim për ndërtimin e autostradës në fjalë me sistemin "Ndërtim me koncesione".

4. Autostrada Tetovë-Jazhincë dhe Jazhincë-Doganaj (Ferizaj)

Gjatësia: 38 km
Gjerësia: 25.5 m
Tunel: 2.500 m
Ura: 1.690 m
Tetovë-Jazhincë (kufiri me Kosovën): 24 km

Jazhincë-Doganaj (Ferizaj): 14 km
Total: 38 km
Shpejtësia: 100 km/h
Kostoja e ndërtimit: afro 116 milionë Euro

5. Autostrada Tetovë-Prizren

Gjatësia: 44.4 km
Gjerësia: 6 m
Ura: 100 m
Kostoja e ndërtimit: afro 39 milionë Euro

Kjo autostradë kalon nëpër pikat piktoreske të malit Sharr dhe lidh shumë katunde të malit Sharr me autostradë moderne. Bën ndërlidhjen e qytetit të Tetovës me katundet Sellcë, Shipkovicë, Brodec, Vicë, Veshallë, Bozovcë nga ana e Maqedonisë dhe nga ana e Kosovës fshatrat Manastiric, Struzhje, Reçane e të tjera fshatra përreth Prizrenit.

Në veçanti po theksojmë se gjithë autostradat e lartë përmendura formojnë një "Korridor" të ri - alternativë e "Korridorit 8". Pikërisht edhe për këtë e kemi pagëzuar si "Korridor 8C".

Ky "Korridor" do të bëjë lidhjen e shumë potencialeve ekonomike siç janë fabrika "Knauf" në Dibër, nga e cila në

ditë ngarkohen 250 kamionë, fabrika "Silika" në Gostivar, fabrika për alumin, fabrika e mikrogranulatave dhe shumë të tjera. Në Tetovë fabrika "Tetek" fabrika "Silmak" e ferosiliciumit, katër fabrika për suvatime të thata, pesë fabrika për përpunimin e qumështit, fabrika për mobilje, fabrika për materiale ndërtuese (tulla), disa gurëthyes dhe biznese të tjera të mesme dhe të vogla. Njëkohësisht këtu ngjitet kompleksi i fabrikave në Ferizaj, dhe Han të Elezit si dhe Prishtina dhe Mitrovica (Trepça). Nga fabrikat dhe subjektet e tjera ekonomike të Shkupit, do të mund të arrijnë në Tiranë dhe Durrës për një rrugë prej 190 kilometrash. Dhe mëse i rëndësishëm është fakti se bëhet lidhja e shkurtër me portet detare të Durrësit, Vlorës dhe Shngjilit. Pikërisht por faktet detar të Durrësit, Vlorës dhe Shngjilit. Pikërisht për faktet ekonomike të lartpërmendura, bartës i projekteve është edhe Oda Ekonomike e Maqedonisë veriperëndimore (OEMVP) me seli në Tetovë e udhëhequr nga Kryetari z. Xhemali Dauti. Projektet e lartpërmendur janë analizuar dhe përmbajtur nga shoqata e Inxhinierëve dhe Arkitektëve me seli në Tetovë, dhe një sërë inxhinierësh nga vendet e rajonit.

Meqë Shqipëria dhe Maqedonia nuk kanë mundësi financiare për ndërtimin e "Korridorit 8C" dhe për shkaqe se dy vendet janë shumë të angazhuar në ndërtimin e disa tjera segmente rrugore gjithashtu me peshë për të dy vendet, si projektues kemi analizuar dhe përfunduar se "Korridorit 8C" mund të ndërtohet me financim nga koncesionarët që janë shumë të interesuar për këtë "Korridor 8C", ka arsytim ekonomik për shkak se më 190 km autostradë lidhen tre shtete. Prej Shkupi deri në Tiranë arrihet vetëm për dy orë. Ndërsa prej Ferizaj deri në Tiranë gjithashtu arrihet vetëm për dy orë, tash arrihet për 6 orë.

Jemi të mendimit se mesatarja e kalimit të automjeteve për një ditë do të afro 10.000 automjete. Njëkohësisht kemi parasysh aspektin e rritjes së numrit të turistëve në drejtim të plazheve të detit shqiptar, nga njëra anë dhe nga aspekti ekonomik që gjithnjë e më tepër rritet numri i subjekteve ekonomike të mesme dhe të mëdhenj. Meqë Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova janë kandidatë për anëtarësim në NATO dhe Unionin Evropian konstatimi është i qartë se do të ketë një zhvillim të fuqishëm ekonomik të kësaj pjese të rajonit të Ballkanit.

Duke uruar fillimin e kësaj ideje, na vafte e mbara në këtë drejtim meqë është interes kombëta në tërësi. Jam i sigurt se projektet tona të kësaj ideje do t'i përkrahin gjithë shqiptarët për brenda etnisë kombëtare në ballkan dhe mbarë shqiptarëve në botë.

* Nga diskutimi në Kuvendin Tekniko-Shkencor mbi Rrugën e Arbërit, Tiranë më 26 maj 2007.

Nga **SUAT SAQIPI, Maqedoni**
ARDIT SELAMI, Shqipëri

Kontrabanda me viça hormonalë nga Maqedonia në drejtim të Shqipërisë është rritur dukshëm, ndërsa nga ana tjetër autoritetet e të dyja vendeve akoma nuk kanë arritur të parandalojnë këtë invazion të gjedheve të rritur në mënyrë artificiale që përbën rrezik për jetën. Kontrabandimi shtrihet në fushën e Klobëçishtit dhe në fshatin Spas, territor i Maqedonisë, ku para organeve policore kufitare të të dyja palëve shihet si në amfiteatër kalimi i kamionëve apo tufat e gjedhëve, kryesisht viça hormonalë. Këta viça hormonalë, dhe jo të garantuar nga ana shëndetësore, merren fare lirë në Maqedoni apo vendet e treta dhe tregtohen në tregun e mishit, kryesisht në Tiranë. Sipas specialistëve të mjekësisë dhe veterinarisë, mishi i tyre është i një cilësie jo të mirë dhe i pa garantuar. "Viçat hormonalë janë ato që rriten, ushqehen dhe mbarështohen me hormone mashkullore në mënyrë që të kenë sa më shumë muskuj dhe të duken shumë të zhvilluar, të arrijnë mbipeshë", - thekson specialisti i Veterinarisë, Agron Ramadani. Sipas tij, rreziqet janë të mëdha, ndaj duhet ndaluar konsumimi i mishit të këtyre llojeve të viçave nga njerëzit.

Fillimi i pluralizmit bëri që në fshatin Reshan të Shqipërisë të bëhej pazari për shkëmbimin e mallrave nga fshatrat përreth kufirit shqiptar të djathtë hollandez, gjalpiti, mishinga ndihmat e jashtme, ndërsa nga Dibra transportohej koka-kola, rroba apo orendi të nevojshme shtëpiake, dhe nga mungesa e parave, e gjithë kjo tregti zhvillohej me këmbim mallrash. Por tashmë prej të gjitha këtyre, biznesi më i preferuar ilegal është kontrabanda me viça hormonalë. Kontrabanda organizohet nga "tregtarët" apo ndërmjetësuesit, të cilët i marrin mallrat nga njëra anë dhe me fëmijë apo ndërmjetësuesit i transportojnë në anën tjetër të kufirit shqiptar. Ky biznes, sipas dibranëve, shpeshherë realizohet edhe para syve të organeve të policisë kufitare. Edhe organizata ndërkombëtare UNDP dhe OSBE janë të shqetësuara për rritjen e kontrabandës në këtë rajon. Ato kanë kërkuar nga autoritetet vendore të policisë kufitare të rrisin masat për sigurinë e kufirit dhe parandalimin e kontrabandës.

Janë disa destinacione që shfrytëzojnë grupet e organizuara të kontrabandës për kontrabandimin e viçave hormonalë në Shqipëri. Sipas burimeve që dalin brenda këtyre grupeve, ekzistojnë tre tregje nga ku furnizohet Shqipëria. "Një grup i organizuar kontrabandon viça hormonalë nga Serbia. Tregtarët maqedonas dhe shqiptarë blejnë viça hormonalë dhe gjedhe me çmime të ulëta nëpër tregjet e Serbisë Jugore dhe më pas në mënyrë të organizuar nëpër rrugë ilegale kontrabandohen në Maqedoni. Si pika të rëndësishme të kalimit janë Trgovishtja, rajoni kufitar në jug të Serbisë dhe rajoni përreth fshatrave të banuara me shqiptarë Sopot, Llojan dhe pika të tjera në këtë zonë kufitare në veri të Maqedonisë", - thotë I.M, një tregtar bagëtish në Shkup, i cili thotë se nuk preferon të merret me kontrabandë. Destinacioni i dytë është viçat hormonalë dhe gjedhet nga Bullgaria, të cilët po ashtu kontrabandohen në Maqedoni nga zonat kufitare të Strumicës, Kriva Pallankës dhe rajoneve të tjera kufitare të Maqedonisë lindore, ndërsa më pas po ashtu në mënyrë të organizuar nisen për në territorin shqiptar. Përveç kësaj, në disa qytete të Maqedonisë, biznesmenë dhe blegtorë kanë ngritur ferma në zonat kryesisht malore për rritjen e viçave hormonalë. Pasiqë të rriten nëpërmjet stimulimit artificial ata menjëherë kanë për destinacion Dibrën dhe më pas tregun shqiptar. Nëpër territorin e Maqedonisë janë ferma të subvencionuara nga shteti, që në mënyrë ilegale rrisin viça hormonalë, por një gjë e tillë është një sekret që mbetet larg opinionit. "Në zonat e thella



Kamion që transporton viçat hormonalë

Viçat hormonalë, ja si kryhet kontrabanda me Maqedoninë

malore të Maqedonisë ruhen viçat hormonalë dhe për një periudhë pasi të rriten, ata menjëherë shiten për në tregun shqiptar. Fitimi është i madh pasi ata blihen me çmim të vogël sipas peshës, dhe më pas shiten me një çmim të shumëfishtë", - thekson Ramadani, fshatar nga rajoni i Kumanovës.

Sekserët e viçave marrin 10 euro për kokë

Dy Dibrat në të dyja anët e kufirit janë bastioni më i preferuar për kontrabandimin e gjedhëve dhe viçave hormonalë. Kamionet e ngarkuar me viça hormonalë vijnë në Dibrën e Madhe të Maqedonisë në orët e hershme të mëngjesit dhe më pas në darkë ato drejtohen për në Dibrën e Vogël apo të pagëzuar zyrtarisht si Peshkopia. Viçat hormonalë të cilët për vetë stimulimin jo natyral që janë mbarështuar, kanë nisur një dyndje të madhe viteve të fundit. Bajrami të cilit nuk arritëm t'ia identifikojmë mbiemrin, me mburrje thotë se nuk bëhet liberalizimi i kufirit për kalimin legal të mallrave nga dy vendet, tashmë shumica janë të detyruar të merren me kontrabandë.

"Fillimisht bagëtiti i merrnim nga Shqipëria dhe i shitnim në Maqedoni, por pasi lëvizën çmimet, ne filluam të tregtojmë viça nga Dibra e Madhe për në Peshkopi dhe qytetet tjera", - thotë Bajrami nga një fshat i Dibrës. Tregtarët i afrojnë kamionët të mbushura me viça hormonalë deri në afërsi të kufirit gjegjësisht në fshatin Bllatë apo Spas dhe prej aty ato i dorëzohen fëmijëve apo njerëzve halexhinj për t'i kaluar në territorin shqiptar për një çmim prej 10 euro për kokë bagëtie. "Kontrabanduesit gjithmonë vendosin vëzhgues në pozicione strategjike në kufi disa orë para kalimit të kamionëve, për të monitoruar lëvizjet policore dhe për të raportuar rreth gjërave të dyshimta. Vëzhguesi gjithashtu fiton 10 euro", - thotë një banor i fshatit Bllatë. Kontrabanduesit shfrytëzojnë rrjetin e gjerë të rrugëve të vjetra të cilat kalojnë njëri drejtim nga fshatrat e Maqedonisë Spas pastaj në Reshan dhe dalin në Bllatë të Poshtme, për t'u ndarë në drejtim të Urës së Telit apo në drejtim të fshatit Majtarë e Vojnikë, ndërsa drejtimtjetër është nga rruga e vjetër e fshatit Banjisht dhe vazhdon në rrugën në drejtim të stallave të ndërmarrjes së ish-jugosllave Progres, pra nëpër fushën e Klobëçishtit dhe pastaj shpërndahen në drejtime të ndryshme në territorin shqiptar. Tregtarët e mishit në Peshkopi theksojnë se pas rritjes së çmimit të mishit të gjedhit në Shqipëri, është rritur nevoja për blerjen e viçave

gati nga të gjitha qytetet e Maqedonisë, Serbia e Bullgaria. "Ky kontrabandim nuk bëhet vetëm në Dibër sepse ne me nga tre apo katër kamionë në ditë nuk mund të furnizojmë vetëm zonën e Peshkopisë, sepse Peshkopia ka mbi 170 mijë banorë, kjo realizohet në të gjithë kufirin për rreth Shqipërisë, që nga Mali i Zi, Kosova si dhe këtu në Maqedoni", - thotë V.N, banor i Peshkopisë, i cili nuk dëshiron të identifikohet.

Dyshimi, policia e implikuar në kontrabandën e viçave

Tregtarët dhe dibranët dëshmojnë se është një arsye e sigurt se edhe pjesëtarët e policisë në terren janë të zhytur thellë në këtë biznes. Sipas B.D nga rajoni i Dibrës, policët në terren janë të përfshirë sepse ata marrin para të majme. "Të gjithë e dinë se më mirë është të jesh polic kufitar apo i punësuar në doganë se president shteti, sepse përfitimet janë më të mëdha nga kontrabanduesit që paguajnë shumën të mëdha lekësh për çdo kalim të mallit", - thotë B.D, duke shtuar se ka dëgjuar se shumë policë janë të detyruar të merren me këtë gjë, për shkak të pagave të vogla, statusit të parregulluar dhe me kontrata afatshkurtra të punës.

Pushteti lokal i Dibrës dhe përfaqësues të organeve policore disa herë kanë kërkuar rritjen e numrit të policëve. Organet policore të këtij rajoni përjashtojnë mundësinë e përfshirjes së tyre në rrjetet e kontrabandës, por nga ana tjetër, kërkohet rritja e numrit të policisë me qëllim të kontrollit më efikas të tërë pjesës së kufirit. Tani kufirin ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë e ruan policia kufitare. Kreu i policisë së Dibrës së Madhe, Medi Rexha, shprehet se është arritur të zvogëlohet kontrabanda në masë të madhe. "Për këtë kam kërkuar bashkëpunim më të madh edhe me organet sanitare, veterinarinë dhe inspektorët tatimorë që edhe ata të vërtetojnë rregullsinë e transportimit të viçave, ndërsa ne disa herë kemi konfiskuar me kamionë të tërë të ngarkuar me viça dhe sigurisht angazhimi jonë ka dhënë rezultate të duhura", - theksoi Rexha. Ndërmjet komisariteve policore të dy vendeve mbahen kontakte javore, mujore dhe tremujore në tre nivele. Në këto takime bëhen shkëmbime të rregullta të informacioneve për të eliminuar çdo gjë negative që ndodh në këtë zonë të kufirit. Komandanti i postës kufitare të Gjoricës, Naim Dema, thekson se policia kufitare në disa raste ka parandaluar kontrabandën me viça hormonalë dhe mallra të tjera. "Fillimisht hapja e pikave të reja të kufirit e më pas rritja

e shkallës profesionale të policisë do të sjellin minimizimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat kufitare. Ai paraqet shqetësim edhe rritjen e numrit të hajdutëve që hynë në territorin e Maqedonisë dhe plaçkisin edhe bagëtiti. Vendkalimet kufitare që kërkohen të hapen janë në Strezimir që lidh Dibrën me Kosovën dhe në Mireshe që lidh Dibrën me një zonë të gjerë të rripit kufitar me Shqipërinë. Kjo do ta mundësonte që Dibra të jetë treg i një zone të gjerë dhe do të shpejtonte zhvillimin ekonomik të ndërsjellë, duke ndaluar kalimin ilegal të kufirit. Nga nëntë shkurti i këtij viti, tregtarëve nga Shqipëria u është mundësuar me ligj tregtimi i viçave, por për një kamion të ngarkuar me 80 viça, ata duhet të paguajnë afërsisht mbi 8 mijë dollarë amerikanë. "Fillimisht duhet të posedojmë licencën për tregtim nga Ministria e Bujqësisë e të dyja vendeve dhe çmimet e larta të doganës pamundësojnë zhvillimin e këtij biznesi legal", - thonë një grup biznesmenësh nga Peshkopia, të cilët janë kundër procedurave të shumta të përcaktuara nga autoritetet maqedonase. Sipas tyre, kontrolli i viçave në pikën doganore bëhet një nga një nga ana e autoriteteve të veterinarisë dhe për këtë duhet që çdo viç të ketë certifikatë dhe raport të veterinarisë.

Sa fitojnë kontrabanduesit e viçave hormonalë

Derisa çmimi i mishit të gjedheve në tregun e Maqedonisë shkon rreth 3-4 dollarë, në tregun shqiptar ai është i dy herë më i shtrenjtë. Sipas të dhënave të marra për çmimin e mishit në Maqedoninë dhe Peshkopi ai sillet rreth pesë mijë e pesëqind lekë për një kilogram mish apo pesë dollarë e gjysmë, ndërsa në Tiranë mishi është edhe më i shtrenjtë që shkon shitja për një kg nga gjashtë dollarë amerikanë deri në gjashtë dollarë e gjysmë. Por duhet shtuar se me mjaft leverdi në Shqipëri është edhe shitja e lëkurës. Njëri nga fermerët më të mëdhenj në Dibër, Murat Daci, (tufa e tij e dhenve përbëhet prej 700 krerë dele), dhe i njëjti zotëron edhe një stallë të madhe për rritjen e 600 viçave. Ai thekson se nga Ministria e Bujqësisë e Maqedonisë nuk i është dhënë leje për shitjen e viçave në Shqipëri, të cilët ai thotë se është duke i rritur sipas kushteve të përcaktuara nga specialistët e veterinarisë. "Shteti në vend që të motivojë dhe të mbështesë tregtinë legale, përkundrazi krijohet hapësirë për rritjen e kontrabandës së viçave hormonalë, mishi i të cilëve është i pakontrolluar dhe paraqet rrezik për konsumatorin shqiptar", - thotë Daci. Ai dhe kolegët e tij janë të shqetësuar për mosinteresimin e autoriteteve qeveritare për parandalimin e kontrabandës. Ata theksojnë se qyteti i tyre po merr imazhin e një vendi tranzitor të kontrabandës. Viçat shiten në pazarin e bagëtie ditën e diel në Komunën e Peshkopisë nga vetë kontrabanduesit si dhe nga ndërmjetësuesit. Autoritetet lokale të dy Dibrave për arsye të ndryshme janë të përmbajtur që të komentojnë rrugët e kontrabandimit. Udhëheqja e pushtetit vendor në Dibër ka kërkuar që të lejohet kalimi legal i organizuar i viçave dhe bagëtie, pasi është rritur nevoja e furnizimit me mish dhe bagëti në pjesën verilindore të Shqipërisë. Kryetari i kësaj komune, Argëtim Fida, ka kërkuar që në këtë rajon të ndërtohet një terminal për zhdoganimin e mallrave që do t'i shfrytëzonte edhe Shqipëria. Kjo sipas tij, do ta ulte tregtinë jolegale dhe kontrabandën e mallrave si dhe koston e shpenzimeve. Përkundrazi këtyre thirrjeve dhe mesazheve për parandalimin e kalimeve jolegale në këtë rajon, kontrabanda me viça hormonalë tashmë mbetet si një biznes më i leverdishëm tek shumica e dibranëve të fshatrave kufitare.

(Hulumtimi është mbështetur nga projekti SCOOP dhe Asociacioni Danez për Gazetari Hulumtuese. Marrë nga www.shekulli.com.al. 23-07-2007)

Golloborda, skaji i harruar i Shqipërisë lindore

Nga **ARTAN HOXHA**

Malet e Gollobordës na shfaqen me gjithë bukurinë dhe ashpërsinë e tyre sapo kalojmë fshatin Llangë dhe zbrësim poshtë malit të Mirakës. Masivi shkëmbor gati i zhveshur krejtësisht nga bimësia sikur t'i kishte ndodhur një hata e madhe, është në kontrast të madh me masivet e tjera malore që e qarkojnë, të cilat janë të mbuluara nga pyje madhështore. Pikërisht kjo pamje e zhveshur nga bimësia i ka dhënë emrin masivit malor në të cilin shtrihet krahina e Gollobordës. Në gjuhën shqipe Gollobordë do të thotë "malet e zhveshura", ose më popullorçe, siç na e thotë një banor i zonës, "malet tullace". Për të shkuar në zemër të kësaj krahine gati të veçantë me pjesën tjetër të vendit ndjekim rrugën që kalon nga Librazhd dhe ngjitet përpjetë Lunikut. Pavarësisht se në hartë ky aks rrugor shënohet si rrugë kombëtare, gjëndja e saj në të vërtetë lë shumë për të dëshiruar. Drejtuesi i fuoristradës me të cilën udhëtojmë përipiqet që të shmang sa më shumë të jetë e mundur gropat dhe gungat e pafundme të rrugës. Në të dalë të Librazhdit, në anë të rrugës hasim një burrë që në pamjen e jashtëme e tregon shumë më të moshuar nga ç'mund të jetë në të vërtetë, i cili na bën shenjë me dorë për ta marrë në makinë. Nuk e humbim një shans të tillë. Jo pse do ta ndihmojmë sadopak mysafirin me emrin Skënder, por do të kemi një udhërrëfyes për në destinacionin për ku jemi nisur, ose më mirë një "cicëron" të tabanit popullor. Pasi shkëmbejmë përshëndjetjet e rastit, ai na pyet për ku jemi nisur. Në dorë mban një qese të errët që e shtërngon fort, a thua se ka ndonjë gjë me vlerë të jashtëzakonshme dhe ka frikë se mos ia rrëmben kush. Kur e pyesim se çfarë ka brenda saj ai rrudh fytyrën dhe më pas përgjigjet. "Epo çfarë të kem tjetër një tufë me farmakë, apo ilaçe për të mbajtur shpirtin gjallë. Ja për këto të flamosura kam zbritur sot qysh pa gdhirë në Librazhd. Apo kushtojnë pak, sikur ble flori jo helm", na thotë me një trishtim që nuk e fsheh aspak Skënderi. Kur e pyesim edhe sa vjeç do të dalë në pension ai na e kthen gjithë ironi: "A ha, vate ajo punë. As që kam shpresë se do ta ha ndonjë ditë atë të shkretë pension! Tani që qeveria ka ndryshuar dhe ligjin, duke e rritur dhe nja pesë vjet moshën e pensionit, më duket se kam për ta marrë nja dy vjet pas vdekjes", - thotë Skënderi.

GOLLOBORDA

Duke qarë hallet me plakun, i kemi shpëtuar paksa monotonisë së rrugës së pashtruar dhe si papritur gjendemi në hyrje të fushëgropës së Stërblevës. Pasi jemi ngjitur përpjetë për më shumë se një orë e gjysëm përpara në shfaqet me gjithë mrekullinë e saj kjo fushë e bukur që të krijon përshtypjen e një krateri vullkani. Rrethohet gjithandej me maja malesh, shpatet e të cilëve janë të veshur me pyje të dendura deri

poshtë ku nisin livadhet e gjelbërta me bar të harlisur. Disa parcela të mbjella me patate dhe thekër, shpërndarë andej këndeve nëpër fushë janë të vetmet që dëshmojnë praninë e njerëzve në këto anë. Kjo mrekulli e rrallë e natyrës është një destinacion i shkëlqyer për turizmin malor, por largësia nga qytetet më të afërta me të dhe rruga e keqe, e kanë lënë në harresë. Madje të duket sikur për të shkuar aty duhet të udhëtosh deri "mbrapa diellit". Duke u zhytur në thellësinë e fushës hasim në të rrallë ndonjë vendali që gati i thyer më dysh prashit patatet, specialitet i trevës. Kopetë e bagëtime janë të vogla dhe si barinj të tyre shërbejnë fëmijë të vegjël apo vajza adoleshente. "Barinjtë modernë" të kësaj ane të detyruar nga kushtet e vështira të jetesës, kanë lënë mënjanë librat e shkollës për të nxjerrë në kullotë bagëtinë, që padyshim është ndër të ardhurat kryesore për të mbajtur gjallë familjet e tyre. Ky soj barinjsh qëndron në grupe nga dy-tre-katër apo më shumë. Si duket jo vetëm për ta kaluar sa më mirë të jetë e mundur kohën në kullotë, por dhe për t'i dhënë zemër njëri-tjetrit ku kopetë e tyre bëhen gjah i egërsirave që janë shtuar së tepërmi. Para se të ngjitemi aty ku ndodhet posta e policisë së Stërblevës, e cila kontrollon kufirin me Maqedoninë hasim në krah të rrugës një grumbull godinash njëkatëshe dhe dykatëshe që nga pamja e jashtëme duken qartë se dikur kanë shërbyer si repart ushtarak apo si fjetina për ushtarët e Shqipërisë Socialiste. Por këtu, këto lloj godinash nuk janë katandisur si në shumë pjesë të tjera të vendit, në gërmadha të një beteje që nuk u bë kurrë me armikun imagjinar. Banorët më të varfër të fshatrave të thellë të Gollobordës kanë zbritur në to dhe i kanë përshtatur në shtëpi banimi. Madje në fshatin Mireshe, buzë kufirit me Dibrën e Madhe, të njëjtin fat ka pësuar dhe ish-posta e policisë, e cila deri tre vjet më parë ishte streha e rojeve të kufirit shtetëror. Ky transformim i objekteve ushtarake në verilindje të vendit është fakt që dëshmon se kufirin ndërshtetëror tashmë e patrollojnë vetëm kafshët e egra dhe tekut ndonjë kontrabandist viçash.

TREBISHTI

Rruga na nxjerrë në krah të Ostrenit të Vogël, një fshat që duket sikur është mbërthyer fort me thonj në shpatin e pjerrët të një kodre të zhveshur për të mos rrëshkitur poshtë në



Rruga nacionale Gollobordë - Librazhd

përrua. Përpara na shfaqet pjesa shqiptare e mbetur matanë kufirit shtetëror. Qyteti i Dibrës së Madhe dhe fshatrat rreth tij shpërndarë si me dorë në kurizim e malit. Ndërsa poshtë në përrua, një grumbull grash dhe vajzash të reja nga Ostreni i Vogël, kanë ngritur kazanët me ujë të valuar dhe lajnë rrobat. Duket si një skenë e huazuar nga ndonjë film me temë, shekujt e kaluar. Por ky përrua me ujë akull të ftohtë që duket sikur mbin nga toka vetëm disa qindra metra më lartë është shpresa e vetme për mbijetesën e fshatit. Nga shtrati i tij deri lart në fshat nuk është më shumë se 300-400 metra distancë, por askush nuk është kujtuar që ti shpëtojë këto gra nga tortura e përditshme e të larit të teshave si qëmoti. Prej Ostrenit të vogël Trebishti, një nga fshatrat më të mëdhenj të zonës është shumë pranë. Ai na shfaqet krejt ndryshe nga Ostreni. Një fshat i madh, i shtrirë sa të ha syri në faqen e butë të malit. Gjelbërimi i harlisur i pemëve të shumta nuk ia ka dalë mbanë të mbulojë gjithë fshatin. Trebishti është një fshat që numëron rreth 2000 banorë, por deri në mesin e viteve '90 ai kishte dy herë më shumë se sot. Tre lagjet e mëdha Muçinë, Balonjë dhe Çelebi, lidhen aq natyrshëm me njëra-tjetrën, sa të duket sikur janë gishtatat e një pëllëmbë të shtrirë. Nga bashkimi i tyre rrjedh dhe emri i fshatit Trebisht (tre bishta). Minareje e hirtë e një xhamije të re të sapondërtuar në qëndër të fshatit na bën me dije identitetin fetar të banorëve të fshatit. Në qëndër të Trebishtit,

ndodhet një lapidar i mbajtur mirë, mbi të cilin janë gdhëndur emrat e dhjetëra dëshmorëve të zonës që kanë dhënë jetën për çlirimin e saj. Karshi tij janë vendosur tre-katër lokale dhe disa njësi tregëtare që shesin gjithëçka që mund të blihet në këto anë. I nxehti i madh që kemi lënë pas në Tiranë këtu duket se nuk ka fare punë, përkundrazi klima është e freskët dhe e shëndetëshme.

DIPLOMATËT

Një nga pronarët e lokaleve ku ulemi për të pirë një birrë, na pret me këmbët e para: "Mos u lodhni kot, nuk kam fare pije të ftohta, madje as ekspresin nuk ua bëj dot. Jo se s'kam, por këtu kemi vetëm tre orë drita dhe frigoriferin e përdorim më shumë për dollap sesa për atë që e ka prodhuar fabrika. Më mirë po u jap nga një raki thane për të mos u nxjerrë bosh". Një djalë i ri i sapo kthyer nga Greqia na thotë: "Ja për këtë punë kemi ikur nga fshati. S'ka rrugë, s'ka drita, s'ka shkollë, s'ka punë. Ti e sheh se të gjitha parcelat në fshat dhe rrotull tij janë punuar, por kaq nuk mjafton. Deri 10-12 vjet më parë fshati kishte dy shkolla të mesme, kishte qendër shëndetësore. Ndërsa sot ka mbetur vetëm shkolla 9-vjeçare. Sa për doktor, shqyr zotit jemi të fortë". Kur i pyesim një grumbull të rinjsh që janë mbledhur rreth nesh se çfarë janë, pasi veç gjuhës shqipe ata komunikojnë dhe në një dialekt të sllavishtes, njëri prej tyre na u përgjigj: "Po deri sa jetojmë në Shqipëri e flasim shqip jemi shqiptar. Kemi pasaportë shqiptare dhe zbatojmë ligjet e Shqipërisë. Këtu kemi shtëpitë dhe tokat tona, këshu që s'ka llogjikë tjetër. Kanë ardhur diplomatë bullgarë, maqedonas e tani sëfundi dhe grekë për të na përfshirë në listat e tyre, por mbetemi shqiptar pavarësisht se qeveria Shqiptare s'po e çan kokën shumë për ne. Këta tanët na kanë harruar, kurse bullgarëve, maqedonasve e grekëve s'jemi duke u zënë besë". Gani Shahini ka një tjetër hall. "Këtu merr

vetëm TVSH-në, ndërsa për kanalet e tjera televizive apo gazetat as që bëhet fjalë. Sa për televizionet në gjuhën maqedone kemi boll, tre stacionet shtetërore dhe disa kanalet private. Sëpaku të na sjellin një antenë për kanalet private shqiptare, të marrim vesh çfarë ndodh dhe çfarë bëhet". Ndërsa një tjetër banor i fshatit që ka punuar dikur në polici na thotë se: "Bullgarët na kanë thënë se duan të na japin shtetësinë shtetësin bullgare. Mbase se kanë keq se tani kanë hyrë dhe në Bashkimin Evropian, e prej tyre udhëtojmë qyl nëpër Evropë si himarjotët. Maqedonasit na thonë se jemi maqedonas, madje disa vjetë më parë u ngritën disa banorë të zonës dhe hartuan një petition ku kërkonin bashkim me Maqedoninë. Po ç'e duam, ata janë më fukarenj se ne. Tani në fund na ka vizituar shpesh herë dhe një Vasil, Vasil, i ambasadës greke. Bile kjo ambasadë ka financuar dhe rikonstruksionin e shkollës së fshatit. Po ç'e do, si kofini pas të vjelit, tani njerëzit kanë marrë rrugët e janë drejtuar në qytetet e mëdha". Largohemi nga Trebishti dhe banorët e tij me shpresën se një ditë dikush nga qeveritë apo deputetët shqiptarë do të kujtohet dhe për hallet e këtyre njerëzve punëtorë. Gjatë kthimit diku afër fshatit Klenjë, hasim në një pritë me gurë në rrugë. Sigurisht përshtypja e parë nuk është e mirë, për më tepër kur vetëm para disa orësh kishim kaluar në këtë aks. Për një moment na vjen në mend '97-ta dhe ditët e trazuar të saj me kusarë dhe maska që sulmonin e grabisnin udhëtarët dhe mjetet në rrugë. Kjo trevë nuk është shquar për gjëra të tilla, prandaj përipiqemi ta marrim me të qeshur dhe si një lojë fëmijësh. Mbase dikush nga banorët e fshatit mund të ketë ndonjë konflikt me dikë tjetër dhe për fat të keq hasëm në të. Gjithsesi një grumbull gurësh nuk mund të na e prishë përshtypjen e mirë që krijuam për Gollobordën dhe banorët e saj.

Marrë nga "Gazeta shqiptare"



HISTORI EMIGRACIONI / NJË VIT VUAJTJE TË VOGLUSHES FITORE BAHTIRI TE PRINDRIT E SAJ NË SHBA

Bashkimi familjar përplot me trauma

Nga REXHEP TORTE

Tashmë u mbush një vit, nga data 8 maj 2006 kur në ora 2 të mëngjesit u nis nga Dibra e Madhe për në aeroportin e Shkupit voglushja kosovare Fitore Bahtiri, për të udhëtuar me aeroplan në Nju Jork, për të bashkuar pas shtatë vitesh me prindërit e saj biologjikë Abdyl dhe Myrvete Bahtiri. Tashmë tetë vite radhazi jam duke e ndjekur jetën e kësaj vogluseje kosovare, për çka edhe shkrimet e botuara në të përditshmen «Fakti» në Shkup lidhur me këtë vogluse, u shpërblyen nga Instituti maqedonas për media, si ndër historitë më të mira hulumtuese të botuara në vitin 2006.

Nisja e kësaj vogluseje për në SHBA ishte ditë gëzimi për të gjithë ata që e njohën, por ja që fati u këthye mbrapsht dhe në vend që të përballtet të paktën me një përpjekje ngrohtësie njerëzore të prindërve të saj biologjikë, ajo që në takimin e parë u desht të ballafaqohet me sjellje arrogante dhe me traumat të pamerituar për një krijesë aq të njomë fëmijërore të shkaktuara nga vetë prindërit e saj.



Abdyl dhe Myrvete Bahtiri, prindërit biologjikë të vogluses Fitore

SI MBETI VOGLUSHJA KOSOVARE NË DIBËR

Në mesin e disa mijëra të zhvendosurve kosovarë që në vitin 1999 erdhën në Dibër për të shpëtuar nga masakrat dhe dhuna serbe, familja e Abdyl e Myrvete Bahtirit nga fshati Sibovc i Podujevës, u vendos në shtëpinë e familjes dibrane nëntë anëtarëshe të familjes së Sakip dhe Bujare Veliut. Familja Bahtiri kur erdhi në Dibër kishte vetëm djalin Shkëlzenin tetëmuajsh, ndërsa Myrvetja ishte shtatzënë.

Pasi u çlirua Kosova, Abdyl dhe Myrvete Bahtiri për shkak të shtëpisë së djegur në vendlindje, u drejtuan në Organizatën Ndërkombëtare të Emigracionit me seli në Shkup, për të kërkuar të udhëtojnë për në SHBA. Përfaqësuesit e IOM-it udhëtimit për në SHBA ua kishin caktuar më datë 22 gusht të vitit 1999. Ndërkaq më 1 gusht të vitit 1999, Myrvetja lindi vajzë në Dibër që e pagëzuan Fitore. Familja Bahtiri nga frika mos u dështojë udhëtimi në SHBA, pa dijen e familjes Veliu, përfaqësuesve të IOM u deklaroi se foshnja u ka vdekur. Më 22 gusht udhëtojnë për në SHBA, ndërsa Fitoren foshnjë trejavëshe e lënë në Dibër nën përkujdesjen e familjes së Sakip dhe Bujare Veliut, që me të arritur atje t'i bëjnë dokumentet për bashkim familjar.

"I trishtueshëm dhe i paharruar ka mbetur në kujtesën tonë ai mëngjes, kur Fitores së vogël trejavëshe babi Abdyl dhe nëna Myrvetja ia puthën syçkat në gjumë dhe e lënë të jetojë me ne në Dibër, ndërsa ata udhëtuan për në Staten Island të SHBA-ve. Nuk e kuptojmë as vetë se si u bë një gjë të tillë, por na u lutën shumë dhe ramë dakord", thonë Sakip dhe Bujare Veliu.

ODISEJADA SHTATËVJEÇARE E FITORES

Me të konfirmuar arritjen e familjes Bahtiri në SHBA, Sakip Veliu filloi kompletimin e doku-

mentacionit të vogluses Fitore për bashkim familjar me prindërit e saj biologjikë. Por u befusua për të keq kur mësoi nga IOM se gjatë përgatitjes për udhëtim në SHBA, familja Bahtiri e kishte deklaruar voglusen si të vdekur. Kjo deklaratë i shkaktoi Sakip Veliut shumë përpjekje për të dëshmuar nëpërmjet gjëndjes civile dhe vaksinave se Fitorja është gjallë dhe shëndoshë e mirë. Ndërkaq familja Bahtiri nuk tregonte asnjë shenjë interesimi për voglusen. Për këtë shkak Sakip Veliu në vitin 2000 udhëton personalisht në SHBA dhe në Zyrën e migracionit i tregojnë se familjes Bahtiri i kanë dërguar shkresë lidhur me dokumentacionin për bashkim familjar, por ajo nuk është para-

që unë ta mar Fitoren e të shkoj te fëmijët e mij. Edhe pse Fitorja qante, «mami mos më ler, unë dua të vij me ty», më në fund u largova me kusht që të shkoj çdo ditë te ata, derisa Fitorja pakashumë të përshtatet dhe ta kuptojë se ata janë prindërit e saj të vërtetë. Të nesërmen kur shkova ta shoh Fitoren në vend të mirëseardhjes, prindërit Bahtiri mu drejtuan me fjalët, «Shporru s'ke ç'kërkon më këtu, mos t'i shohim sytë më», dhe derisa po mundohesha tu spjegoj se kështu Fitorja mund të merr ndonjë traumë, Abdyl më kapi për krahu dhe më përplasi jashtë para syve të Fitores, e cila qante duke më lutur, «Mami merrmë të vij me ty, nuk mund të rrij këtu».

AMBASADA NË SHKUP E GATSHME PËR TË NDIHMUAR

Të shokuar nga e tërë ajo që ndodhi me voglusen në SHBA, Sakip dhe Bujare Veliu i drejtohen me një shkresë edhe Ambasadës së SHBA-ve në Shkup dhe Konsullit Kimberly A. McDonald, u kthen përgjigjen në të cilën, thotë se: «Ambasada në Shkup nuk mund të ndërhyjë në punët e një familje private në SHBA. Po ju udhëzoj që për rastin e Fitores të drejtoheni te punëtorët socialë, te punonjësit e policisë, të cilët mund të kontaktojnë dhe të ndërhyjnë te familja Bahtiri për rastin konkret. Unë po ju dërgoj edhe adresat për të kontaktuar me policinë, dikasterin për probleme sociale dhe dikasterin për ndihmë viktimeve të keqtrajtohen».

IOM DHE UNHCR U TREGUAN TË PAPËRGJEGJSHME

Sakip dhe Bujare Veliu, duke shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj IOM dhe UNHCR, thonë se: «Gjatë tërë takimeve që patëm në Shkup me përfaqësuesit e IOM dhe UNHCR, në kohën kur e përgatitnim dokumentacionin për bashkim familjar të vogluses Fitore, në vazhdimësi luteshim dhe kërkonim që vogluses Fitore, t'i bëhet një bashkim familjar sa më i qetë dhe dinjitoz, për të mos i shkaktuar ndonjë traumë psikike, sepse ajo nuk i njeh fare prindërit e saj të vërtetë. Megjithatë IOM dhe UNHCR nuk e kryen deri në fund obligimin ndaj Fitores. Mendojmë se detyra e IOM nuk ishte që voglusen Fitore ta dërgojë vetëm deri në aeroportin «Xhon Kenedi» e të zhduket fare, por përfaqësuesja e IOM-it duhej të vinte edhe në banesën e Abdyl dhe Myrvete Bahtirit, të shikonte se çfarë kushtesh ka atje, dhe të paktën t'i spjegonte apo t'i rekomandonte familjes Bahtiri, që për një periudhë përshtatjeje ta lejonte Bujaren të qëndrojë pranë kësaj vogluseje. Po të ishte vepruar kështu besojmë se nuk do të ndodhnin tërë këto të papritura skandaloze ndaj vogluses Fitore dhe ndaj nesh që e rritëm me aqë kujdes e dashuri. Për këtë arsye mendojmë se IOM dhe UNHCR nuk e kryen punën e tyre si duhet».

PRONONCIM I ABDYL BAHTIRIT, BABAIT TË VËRTETË TË FITORES

Meqenëse edhe shkrimet e



Sakip dhe Bujare Veliu, dibranët që e rritën që tri javëshe deri 7 vjeç voglusen Fitore

shumta brenda këtyre tetë viteve lidhur me Fitoren kosovare nuk rezultuan qoftë edhe me një prononcim të vetëm të familjes Bahtiri, ne angazhuam një mikun tonë në Nju Jork, që ta gjejë dhe të zhvillojë të paktën një bisedë me Abdyl Bahtirin, për të kuptuar pse këta prindë u sollën aqë keq me dibranen Bujare Veliu, e cila e rriti këtë vajzë që foshnjë trejavëshe dhe ua solli deri në Nju Jork, e para, dhe, e dyta, pse nuk e lejuan dibranen që për një periudhë të qëndrojë pranë vogluses për t'i mundësuar një bashkim të qetë, dinjitoz dhe human si prindër të saj të vërtetë.

Miku jonë nga Nju Jorku, lidhur me këtë, u përgjigj se: «Abdyl Bahtiri në mërgatën shqiptare konsiderohet si tip grindavec, gjë që e ka dëshmuar me sjelljet e tij nëpër klubet ku gravitojnë shqiptarët, duke bërë disa zënka. Unë gjeta rastin në njërin nga klubet tona të bisedoj me të. Ai plot arrogancë, butalitet, paturpësi dhe pa asfarë argumentimi bindës, shprehet se nuk është fare mirënjohës ndaj familjes Veliu nga Dibra, e cila ia rriti këtë vogluse. Ai përdor arsyetime banale dhe të pavërteta, se gjoja voglushja Fitore paska qenë e veshur keq dhe e paushqyer sa duhet, se gjoja familja dibrane Veliu e paska zvarritur arrijtjen e vogluses për në SHBA. Dhe fundja më tha, «ja që voglushja erdhi dhe u bashkua me ne, e tani pse nevojiteshka të interesohet edhe më familja dibrane për të». Në përgjigjen time se nuk është e ndershme të flet kaqë padrejtësisht për një familje fisnike dibrane, të cilën e njohin tërë dibranët, dhe se do të ishte mirë edhe për voglusen që për një periudhë kohore ta kishte pranë Bujare Veliun, e cila e rriti me aqë mund e kujdes, Abdyl me një neveri abnormalë, mu përgjigj, «shikoni punët tuaja» dhe u largua nga tavolina ku ishim ulur.

VOGLUSHJA FITORE DUHET NDIHMUAR

Rasti i vogluses Fitore është i rallë dhe shumë i ndërlikuar. Sa herë që mundohem ta vë veten time apo të dikuj tjetër në pozicionin aktual të Fitores, më da-

lin shumë përgjigje trishtuese. Edhe mua me këtë moshë që kam, por edhe cilindo person tjetër të moshës madhore, po të na merrte dikush e të na çonte tejoqeanit për të na thënë thjesht, «ja këta janë prindërit e tu të vërtetë», një gjë të tillë vështirë se do të mund ta prananim. Po sikur kësaj t'ia shtojmë edhe sjelljen arrogante të personave prindër të vërtetë ndaj një gruaje, e cila na ka rritur dhe të cilën gjithnjë e kemi njohur si nënë, kjo me siguri që edhe ne do të na vente në siklet të madh. Por sikur kësaj t'ia shtonim edhe izolimin dhe bunkerizimin e tërësishëm të menjëhershëm, nga persona që nuk i ke njohur kurë më parë, kjo me siguri do të ishte e papërballueshme për çdo krijesë njerëzore normale, qoftë edhe e moshës madhore, e lene më për një vogluse shtatëvjeç të shkëputur nga një ambient siç ishte Dibra, dhe nga njerëzit që gjithnjë i falnin gëzimin e lumturi.

Droja jonë është se tashmë një vit në shpirtin e kësaj vogluseje ka filluar t'i mblidhet një lamsh plot me trauma dhe dilema, të cilat do ta ketë vështirë t'i zgjidh gjatë tërë jetës së saj. Kësaj vogluseje pa fajin e saj, i janë krijuar shqetësime që vështirë se mund t'i zgjidhnin edhe psikoanalistët më të shquar.

KONTAKTIMI I BUJARES ME FITOREN DO TA ZBUSTE SITUATËN

Sakip dhe Bujare Veliu duke mos reshtur së menduari dhe duke mos humbur shpresën për t'i ndihmuar vogluses Fitore, si më të arsyeshme kanë zgjedhur rekomandimin e konsullit të Ambasadës së SHBA-ve në Shkup. Në këtë drejtim ata kanë përpiluar letrat adresuar te dikasteri policor, ai për probleme sociale dhe dikasteri për ndihmë viktimeve që keqtrajtohen, me kërkesë të bindet familja Bahtiri, që vogluses Fitore kohë pas kohe t'i gjendet pranë Bujare Veliu, që vogluses Fitore t'i mundësohet të kontaktojë dhe me telefon me anëtarët e familjes Veliu në Dibër, si të vetmen mënyrë, që kësaj vogluseje t'i zbuten sadopak plagët shpirtërore nga vështirësitë e krijuara.

“Kalorësi fisnik i historisë së psikologjisë shqiptare”

Nga Dr. LAURANT BICA

Nuri Abdiu është një ndër themeluesit e shkollës së sotme psikologjike shqiptare dhe një nga ata që ka përgatitur kuadro dhe për këtë shkollë, një ndihmesë kjo me vlerë kombëtare dhe më gjerë. Për gati gjysmë shekulli ai ka qenë mësues, profesor i psikologjisë dhe ka ligjruar në Universitetin e Shkodrës, Tiranës, Prishtinës, Tetovës etj., brenda e jashtë Shqipërisë dhe është bërë një autoritet i kësaj fushe krahas akademikëve e profesorëve si: Bedri Dedja, Hamit Beqja, Pajazit Nushi, Shefik Osmani, Musa Kraja etj.

Puna e profesor Nuri Abdiut është puna e një njeriu të përkushtuar ndaj studimit të një fushe të zhvillimit të shkencës shqiptare, relativisht të re, siç është ajo e studimeve psikologjike. Këtë fushë, siç thanë vlerësuesit e veprës së tij, ai e bëri “të vetën” dhe u afirmua në të njëjtë punë sistematike. Në sajë të saj, krahas të tjerave ai mori “Medaljen e punës” më 1968, urdhrin “Naim Frashëri” të klasit të parë më 1980, titullin “Mësues i Merituar” më 1987 dhe dy vjet më pas edhe titullin më të lartë, “Mësues i Popullit”. Një trajektore ngjitëse që flet më shumë nga gjithçka tjetër. Nga 1969, kur kumtoi për herë të parë në Konferencën I Kombe të Studimeve Pedagogjike edhe për H. Tahsinin e deri më sot te monografia për një vepër të tij, kemi përsëri një tjetër trajektore ngjitëse të studimeve të Nuri Abdiut për këtë rilindës, rritje kjo si sasiore, ashtu dhe cilësore. Ne kemi besimin se pas kësaj rruge ngjitëse gati 40-vjeçare, profesori do të kapë kuota të tjera më të larta... Po kështu edhe shkallët e karrierës pedagogjike e shkencore (edhe kjo një trajektore tjetër lartësuese) flasin akoma më tepër: titulli shkencor “Docent” më 1973, grada “Doktor i shkencave” më 1991 (nga të parët në fushën e psikologjisë) dhe titulli shkencor “Profesor” më 1999.


Prof. Nuri Abdiu ka meritën se ka zbuluar dhe një sërë personalitetesh që vlejën si për mendimin psikologjik, ashtu edhe për atë filozofik shqiptar. I tillë është Branko Merxhani, Isuf Agjah Korça etj. Me këtë rast nuk mund të mos përmendim se puna e tij në fushën e psikologjisë është çmuar, duke e futur në redaksinë e Enciklopedisë Shqiptare për hartimin e zërave respektive...

Me dekada të tëra ky njeri u rropat nëpër ravat e jetës dhe të shkencës së

Puna e profesor Nuri Abdiut është puna e një njeriu të përkushtuar ndaj studimit të një fushe të zhvillimit të shkencës shqiptare, relativisht të re, siç është ajo e studimeve psikologjike. Këtë fushë, siç thanë vlerësuesit e veprës së tij, ai e bëri “të vetën” dhe u afirmua në të njëjtë punë sistematike.

psikologjisë. Rezultat i kësaj pune të lodhshme ishte studimi “Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar”, Tiranë 2002. Teksa po shihja orarin më tërhoqi vëmendjen një lëndë e posaçme në degën e psikologjisë, “Kursi Special”. E pyeta profesorin dhe u gjenda para një befasie të dytë për mua. Në atë kurs jepej një lëndë e re, “Historia e Mendimit Psikologjik Shqiptar”, prej vetë autorit të saj. E urova me gjithë zemër që kjo lëndë e re kish marrë “rrugë” në programet e Universitetit “UFO” dhe ta hiqte “këmbën zvarrë” duke u dhënë në Universitetin Shtetëror të Tiranës e prej andej në mbarë universitetet shqiptare, shtetërore apo private qofshin, në tërë trojet etnike shqiptare. Dhe s’janë pak. Numri i tyre po i afrohet me shpejtësi 40-ës dhe vitin tjetër akademik, shkollor e kalon këtë shifër...

Një etje e paduruar për arsim, kulturë e shkencë e popullit tonë, e shqiptarëve kudo që janë... Shpresoj dhe besoj që në një të ardhme të afërta “Historisë së Mendimit Psikologjik Shqiptar” të Prof. Dr. Nuri Abdiut t’i shtohen dhe “Historia e Filozofisë Shqiptare”, “Historia e mendimit Ekonomik Shqiptar” etj., etj. Arsimi shqiptar pret “kalorësit e rinj” të këtyre shkencave shqiptare dhe njëkohësisht lëndëve mësimore të nesërme në universitetet tona të vjetra e të reja, sikurse “kalorësi i psikologjisë”, Nuri Abdiu, siç e përcakton i ndjeri akademik Prof. Bedri Dedja. Uroj më që të tillë “kalorës” të shumohen për të mirën e shkencës shqiptare, për t’i treguar botës se në këto troje të Ballkanit jeton një popull që i ka dhënë në shekuj, i jep sot dhe do t’i japë shkencës botërore në përgjithësi ndihmesën e vet të vyer. Detyra jonë është ta zbulojmë këtë kontribut në fusha të ndryshme të saj dhe



të bëjmë të vetëdijshëm brezat e sotëm e të ardhshëm për vlerat tona si popull, si komb. Detyrë sa e vështirë, aq dhe fisnike, por dhe që të mbush me krenari. Prof. Dr. Nuri Abdiu është nga ata personalitete të shkencës sonë, që e ka përbushur këtë detyrë qysh sot, pas dekadash të tëra pune këmbëngulëse e të suksesshme. Lënda e re në programet e universitetit “UFO” është një buqetë lulësh në këtë drejtim. Libri për “Psikologjinë e Hasan Tahsinin” është një gur më tepër në “murin” e kësaj shkencë të re...

Pas rreth gjysmë shekulli që Hasan Tahsin dinte bashkë me shqipin 11 gjuhë: tre gjuhët e Lindjes, arabisht, persisht, osmanisht, greqishten e re; greqishten e vjetër e latinishten që e përvetësoi në Sorbonë; frëngjishten e italishten dhe sipas indikacioneve më të fundit që kemi mendohet të ketë ditur dhe anglishten e gjermanishten; një poliglot i vërtetë. Midis të tjerave, vepra “Shkrimet e Popujve” dhe alfabeti origjinal i tij për gjuhën shqipe janë dëshmia më e mirë për këtë...

Pas rreth gjysmë shekulli kërkimesh të studiuesve shqiptarë vjen i mirëseardhur në letrat shqiptare ky punim shkencor i profesor doktor Nuri Abdiut mbi veprën “Psikologjia apo shkenca e shpirtit” të Hoxha Hasan Tahsinin, këtij rilindësit tonë, nga më të shquarit.

Ai u drejtohet të gjithëve, është një libër i hapur për cilindo, por atë mund ta

përdorin në mënyrë të veçantë studentët e degëve të psikologjisë dhe të filozofisë, specialistët e fushave respektive, pedagogët e të gjitha kategorive, mësuesit e shkollave në mbarë vendin etj. Teksti i përkthimit brilant, besnik i origjinalit të veprës të shkruar nga vetë Hasan Tahsin, është sjellë tani në dorën tonë, në dispozicionin tonë. Është një përkthim i bërë nga një mjeshtër, siç ishte orientalisti Vexhi Buharaja.

Me këtë vepër, që i vjen e shumëpritur rrethit të lexuesve shqiptarë, kudo në trojet etnike apo në diasporë, jam i bindur se profesor doktor Nuri Abdiu do të zërë një vend të shquar në kohën tonë si i pari, apo ndër të parët studiues shkencorë të profesor Hoxha Hasan Tahsinin. Ai do të numërohet si një ndër Tahsinianët e parë. Kështu, me këtë emër, do t’i quaja studiuesit e Hoxha Tahsinin, duke filluar nga Sami Frashëri e Naim Farshëri, për të vazhduar me një Riza Tefik e Dervish Hima e të tjerë që u përpoqën, duke filluar nga Rilindja e këtej, ta nxjerrin në dritë dhe ta vënë në vendin e merituar që i takon te ne në Shqipëri dhe në botë...

Çdo mëngjes kur shkoj në punë, rrugës më tërhoq vëmendjen një tabelë rruge: “Profesor Bedri Dedja, akademik, dhe jepen vitet përkatëse të jetës së tij. Ka vdekur tani vonë, para 3-4 vjetësh. Është një tabelë e thjeshtë në atë pjesë të qytetit metropol të shqiptarëve, Tiranës, rreth 1 milionëshe, që quhet Selitë. Një ditë në universitetin “UFO”, ku jap mësim duke parë orarin, ndesha ballë për ballë profesor Nuri Abdiun. Mbante në dorë librin “Nëpër ravat e jetës” (kujtme) të Bedri Dedes. E shfletova dhe midis fletëve pashë një përkushtim: “Nuri Abdiut, kalorësit të psikologjisë..., me respekt autori 29.05.2001”. Libri ka dalë në vitin 2001 në të gjallë të tij. Ishte një befasie e këndshme për mua. Shihja pedagogun Nuri Abdiu të zbardhur nga pesha e viteve, gjithë vitalitet dhe ai përcaktim i profesor B. Dedes për të më dukej më se i goditur.

Zakonisht shkrime të tilla për njerëz të shkencës është e natyrshme të mbylleten me një stil akademik. Unë do të desha t’i largohesha një gjëje të tillë dhe ta përfundoja këtë pasthënie me një mënyrë krejt tjetër... Do t’i krahasoja personalitetet e fushës së psikologjisë me kalorësit e mesjetës. Ka diçka fisnike, madhështore e heroike prej tyre në ta...

Takime sportive e festive në komunën e Gjoricës

Në kuadrin e përmblyjes së vitit shkollor dhe veprimtarive sportive 2006-2007, mësuesi i Edukimit fizik Fadil Cami në bashkëpunim me drejtuesit e komunës dhe të shkollës organizoi një takim sportiv e festiv me vlera ushtruese, argëtuese, çlodhëse dhe edukuese. Ishin të ftuar edhe sportistë veteranë me kontribut në këtë trevë Zenel Izvira, Ismet Jella, Haki Duka, Bashkim Hajdari etj. Veprimtaria startoi me takimin e volejbollit për shkollat djem dhe vajza. Ekipi fitues miks (djem dhe vajza) u ndesh me veteranët, të cilët për nga organizimi i lojës, demonstrimi i elementeve teknike, variacionin e shërbimeve, gjuajtje të rralla etj befasant shikuesit e shumë. Pas ndeshjes nga organizatorët veteranëve ju dhuruan nga një fanellë sportive.

Në lokalit të Elez Budurit, që ua kishte akorduar falas shkollarëve, u zhvillua dreka tematike e dëfrimi. Drejtori i shkollës Avni Mera përshëndeti pjesëmarrësit për mirëseardhjen e ndihmesën e dhënë në kurorëzimin me sukses të procesit mësimor dhe atij sportiv. Veçoi pjesëmarrjen vull-

netare të trupës pedagogjike në këtë veprimtari të rëndësishme e modeste dhe punën e pakursyer të disave prej tyre në fushën e mësimin, edukimit e kalitjes fizike. Promotori i kësaj veprimtarie Fadil Cami, mësues i edukimit fizik e veteran i sportit në këtë komunitet, njohu auditorin me civilin sportive të veteranëve. Zenel Izvira volejbollist përfaqësuar rrethin në të gjitha spartakiadat kombëtare dhe aktivizuar me ekipin e volejbollit të rritur, kategoria e dytë “Korabi” mban titullin “Nderi i volejbollit Dibër”. Ismet Jella organizator i talentuar, anëtar i këshillit të përgjithshëm të BFSSH-së 1979-1982, Haki Duka atlet e basketbollist i “Korabit”, drejtues sporti për vite me radhë, udhëheqës i ekipeve kombëtare, gjimnastikës Kosovë 1976 dhe qitjes Bullgari 1984, botues i librit me shumë vlera “Kultura fizike e sportet në Dibër” mban titullin “Nderi i sportit dibran”, Fadil Cami volejbollist, përfaqësuar rrethin në të gjitha spartakiadat kombëtare, aktivizuar me ekipin e volejbollit “Korabi” me ekipet fituese të shkollës veçanërisht volejboll djem e tërhoqje litari.

Bashkim Hajdari volejbollist në një nga takimet kombëtare cilësuar si lojtari më i mirë i kategorisë së dytë. Gjithashtu prezantoi punë dhe arritjet e ekipeve të volejbollit djem dhe vajza të kësaj shkolle, me stërvitje dhe aktivitet gjithëvjetor, duke mundur moshatarët e tyre në Brezhdan, Matjarë, Bulqizë, Vçisht, Shupenzë, etj. Nxënësit Gilman Miftari dhe Ervis Cami aktualisht mbeten lojtarët më të mirë. Falenderoi përkrahjen e vazhdueshme të drejtorit të shkollës Avni Mera dhe mbështetjen financiare të drejtuesve të komunës Xhelal Mera (kryetar) dhe Liman Gjeleshi. Vallzimet, këngët, intervistat, etj., i dhanë jetë e gjallëri takimit.

Kryetari i komunës z. Xhelal Mera vlerësoi punën pasionante të nxënësve të shkollave, trupës pedagogjike dhe veçanërisht të mësues Fadilit, që në këtë periudhë tranzicioni ka ditur të mbajë të gjallë traditën sportive në këtë komunitet. Nënvizoi që për shkollat e mesme fidanish-tja mësimore e sportive ka qenë shkolla e Gjoricës, si të tillë nxënësit tanë mbeten krenaria e komunës dhe shkollës. Ju kemi mbështetur deri më sot

dhe padyshim për punë dhe vlera si këto do t’iu mbështetim në të ardhmen. Në shtator të këtij viti do të furnizohemi edhe me ujë të pijshëm, etj., citime që për të pranishmit krijohet ngrohtësi e obligim për arritje më cilësore.

Flet veterani Zenel Izvira për pasionin e moshatarëve, sakrificat, thjeshtësinë e bazës materiale, arritjen deri në aktivizimin me ekipin e volejbollit të rritur “Korabi”. Kujton me modesti takimet kombëtare, etj., që lanë mbresa të pashlyera tek dëgjuesit. Haki Duka si sportist, drejtues e hartues i historikut të sportit dibran, sjell nostalgji për vitet 1949-1954, ku Gjorica, e inkuadruar në lokalitetin e Shupenzës merr pjesë me ekipe dhe individë cilësorë. Në vitin 1955 e vazhdim përfaqësohet e vetme në të gjithë veprimtaritë lokale dhe ato kombëtare (spartakiadat), duke i dhënë zë e emër Gjoricës me shkollarë e kooperativistë. Prezanton emrat e mirënjohur në fushën e sportit, Mane Cami, Bukurije Lleshi, Xhelal Cami, Beqir Cami Elez Xheka, Haxhi Lusha, Faik Martini, Fehmi Xhevishi, Muharrem Xheka, Ismet Lella, Munir Tola,

Zenel Izvira, Fadil Cami, Shpëtim Kaja, Bashkim Hajdari, Haki Skënderi, Uke Dumani, Përparim Balliu, Beqir Krosi, Zija Miftari, Nezir Kaja, Dylbin Reçi që kanë vënë vulë në zhvillimin masiv dhe përparimin cilësor të sporteve në këtë komunitet. E ndjej për obligim të veçor mbështetjen e pakursyer të drejtuesve të komunës, nisur nga baza materiale si topa, fanella etj, shpenzimet për ndeshjen me fqinjët e deri tek takimi i ditës së sotme. Këtë unë e kuptoi si një privilegj të arrirë vetëm tek ju, pasi për 17 vite këtë dukuri pozitive nuk e kam hasur në Qarkun e Dibrës e më gjerë. Gjithashtu, mbështetja e fuqishme e drejtorisë së shkollës mbetet një përvojë pozitive. Takohen brezat, kujtojnë, miqësohen, dëfrehen, ndërtojnë të ardhmen. Duhet përgëzuar jo vetëm mbështetja financiare nga komuna, por edhe ndihma modeste e pronarit të lokalit Elez Buduri, dixheistit Blerim Markja, kameramanit Dritan Izvira, fotografit Pëllumb Cami, që pa asnjë lloj shpërblimi ndihman organizatorët për kurorëzimin me sukses të kësaj veprimtarie gjurmëlënëse për nxënësit e shkollave.

DYLBIN REÇI

Festë sportive me nxënësit e shkollave në Peshkopë

Nga HAKI DUKA*

Për një javë radhazi, nga 16 deri me 21 maj 2007, ambientet sportive të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme si dhe bulevardi "Elez Isufi" u gjallëruan së tepërmi nga garimi e konkurrimi në shumë lloje sporti të nxënësve të shkollave.

NGA DITA OLIMPIKE E VRAPIMIT

Dita Olimpikë Ndërkombëtare e Vrapimit prej tre vitesh po festohet me shumë larmi e bukuri veprimtarish edhe në qytetin e Peshkopisë, me synim kthim në traditë për komunitetin e shkollarët tanë. Kjo, falë inicimit dhe mbështetjes së plotë teknike e financiare nga KOKSH-ri me President Z. Hysen Domi dhe sekretar të përgjithshëm z. Stavri Bello. Gjithashtu, për herë të parë Bashkia Peshkopi me kryetar z. Ilir Krosi, në kuadrin e kësaj veprimtarie të rëndësishme sportive pajisi gjashtë shkollat me nga 30 fanella sportive. Ia vlen ta theksojmë se pa një mbështetje të tillë do të ishte e pamundur organizimi, zhvillimi dhe kurorëzimi me sukses i kësaj veprimtarie të gjerë, me vlera të pallogaritshme ushtruese e edukuese. Dita Olimpikë e Vrapimit në Peshkopë 2007, startoi në bulevardin "ELEZ ISUFI" në mëngjesin e 17 majit me konkurrimin e nxënësve të shkollave të mesme, ku pjesëmarrja këtë vit ishte e kënaqshme. Në baterinë e parë distancë 800 m garuan vajzat e vitit të parë dhe të dytë, ku në finish në vend të parë u radhit Rovena Shehu e "S. Najdenit" dhe pas saj Blerina Doda e Rabie Bruci të "N. Rushitit". Në baterinë e dytë me distancë 1000 m konkurruan vajzat e vitit të tretë dhe të katërt. Shiritin e mbërritjes e përqafoi Edlira Sava e "N. Rushitit" dhe në vend të dytë e të tretë u radhitën Teuta Bitri "S. Najdenit" e Nikoleta Cibaku e "N. Rushitit". Për meshkuj konkurrimi u bë më "i ashpër", ku në baterinë e parë të 800 m fitues u shpallën tre garistët e "S. Najdenit": Emri Manja, Briken Boçi dhe Boris Duka, radhitur nga vendi i parë në të tretë. Edhe në baterinë e katërt të 1000 m konkurruesit e "S. Najdenit" nuk lëshuan pe ku Besford Laçi, Elidon Çera dhe Alger Brahasani zunë përkatësisht vendet parë, dytë dhe tretë, duke i dhënë edhe tonin kësaj gare. Në praninë e shikuesve të shumtë gjatë gjithë shtrirjes së bulevardit "Elez Isufi" më 18 maj garuan nxënësit e shkollave 9 vjeçare "D. Gashi", "S. Alliu", "M. Shehu" dhe "I. Hajrullai."

Pozitiv është fakti se pjesëmarrja i kaloi caqet e parashikimit të specialiteteve të fizkulturës. Kjo mbingarkesë disi vështirësoi garimin normal të pjesëmarrësve, megjithatë ajo rriti bukurinë e konkurrimit. Në baterinë e parë të 400 m finishi radhiti të parën Eglja Degjoni të "M. Shehut", në të dytën Flavia Elezi të "D. Gashit" dhe në të tretën Arjola Mera të "S. Alliu". Bateria e dytë në distancën e 600 m po për vajza të klaseve shtata dhe teta rreshtoi nga vendi i parë në të tretin Enilda Miftarin, Josan Xhediku dhe Semiha Shtjefni përkat-

sisht të shkollave "D. Gashi", "S. Alliu" dhe "I. Hajrullai". Për meshkuj në klasat e pesta dhe gjashta në 400 m Xhulian Palluçi i "I. Hajrullai", Algert Manreka i "D. Gashi" dhe Igli Reçi i "S. Alliu" dhe ndanë përkatësisht vendet nga i pari në të tretë. Tre fituesit e vendeve të para për secilën bateri ju akorduan stimuj materialë. Në mbyllje të Ditëve Olimpikë të vrapimit shkolla e mesme "Seid Najdeni" për meshkuj dhe "Nazmi Rushiti" për vajza u renditën përkatësisht në vendet e para. Edhe shkolla 9-vjeçare "Selim Alliu" fiton vendin e parë për meshkuj, ndërsa "Demir Gashi" për femra.

NË JAVËN OLIMPIKE 2007

Java Olimpikë nisi me takimet eliminatore me 16 maj në ambientet sportive të shkollave 9-vjeçare "Irfan Hajrullai" dhe "Demir Gashi", ku pritën mikeshat e miqtë e "Selim Alliu" dhe "Myslim Shehut". Veprimtaritë drejtohetin nga



anëtarët e Komunitetit Olimpik Rajonal Dibër dhe mësues të edukimit fizik Albert Shehu dhe Maksim Xheladini. Në prani të shikuesve të shumtë dhe tingujve të muzikës argëtuese nisi ceremoninë e hapjes në shkollën "D. Gashi". Për afro tre orë djemtë dhe vajzat e të katër shkollave garuan, matën forcat, dhuruan takime me nivel e cilësi gati në të gjithë sportet konkurruese si volejbol, futboll, basketboll, tërheqje litari, etj. Në mbyllje shkollat "D. Gashi" dhe "S. Alliu" u shpallën fituese për në takimet finale. Dhe ja dita e mirëprituar



e finaleve mbërrin. Me 18 maj, orëve të para të pasdites nisin garimet në dy gara atletike dhe pesë sporte në ambientet sportive të shkollës së mesme "Seid Najdeni", zburuar si për ditë feste. Djemtë dhe vajzat e "D. Gashit" në tërheqje litari ishin më të përgatitur dhe fituan përkatësisht 2-0 ndaj asaj "S. Alliu". Në garat e kërcimit së gjati dhe 50 m, Rubin Marrja i "S. Alliu" zë vend të parë, ndërsa Enilda Miftari e "D. Gashit" dhe Elisana Iskurti e "S. Alliu" zënë vendet e para për vajza. Takimi i futbollit u zhvillua në kushtet e një moti të rënduar me shi, ku koha e rregullt dhe shtesa u mbyllën në barazim. Në goditjen nga pika e bardhë futbollistët e "S. Alliu" u treguan më të saktë dhe fituan 3-1 takimin.

Për arsye moti të rënduar takimet e volejbollit dhe basketbollit u zhvilluan në palestër sportive "Korabi", ku të gjithë shikuesit nxënës e prindër e mësues u shpërngulën atje. U desh prania e ndihma e organeve të rendit për të zhvilluar normalisht takimet. Në volejbol femra e meshkuj fitojnë nxënësit e "D. Gashit" përkatësisht me rezultatet 2-0 dhe 2-1. Në basketboll femra dhe meshkuj fitojnë ato të "S. Alliu", me pikavarazh 18-12 dhe 24-17-të. Për meshkuj "S. Alliu" zë vend të parë me 20 pikë dhe për femra "D. Gashi" me 18 pikë. Fakti që të dy shkollat në klasifikimin e përgjithshëm grumbulluan nga 34 pikë secila, tregon për një ballafaqim cilësor e dinjitoz në mes tyre. Një pikë para në kros dhe me tre vende të para në atletikë zgjidh ekuacionin kryegjygtari Fehmi Bulku, anëtar i KOR Dibër dhe mësues i edukimit fizik, ku i akordon vendin e parë shkollës "S. Alliu" dhe në vend të dytë "D. Gashi".

Shkolla e mesme "Nazmi Rushiti" pati mysafirë për finale "Seid Najdenin". Ishte me të vërtetë një pritje e hijshme, nisur nga stafi pedagogjik me drejtues z. Gafur Markeçi deri tek nxënësit e prapavija.

Zburim me parulla të ndryshme, punimet, vizimet, baza materiale e vënë në dispozicion e deri tek kokteji me drejtuesit e mësuesit e edukimit fizik të dy shkollave i dhanë hijeshi, bukuri dhe cilësi veprimtarisë. Pas ceremonisë së hapjes garuan atletet e 50 m dhe të kërcimit së gjati ku "S. Najdeni" si meshkuj edhe për femra meritoi vendet e para me atletët Drilon Muskurti, Abdulla Çenga, Rovena Shehu dhe Teuta Bitri. Edhe në tërheqje litari fitoi 2-0 "S. Najdeni" për djem e vajza. Në basketboll meshkuj, të rinjtë e "S. Najdenit" ishin më të organi-

zuar e më të saktë në gjuajtje, duke mbyllur takimin 37-23 pikavarazh në favor të tyre. Vajzat e "N. Rushitit" po në basketboll me rezultat 29-21 në favor të tyre mbyllën ndeshjen. Takimet e volejbollit si për femra dhe për meshkuj u zhvilluan me shumë rivalitet e tifozëri. Kjo edhe për faktin se ekipet e të dy shkollave ishin përgatitur në nivel të kënaqshëm. Vajzat e "N. Rushitit" fituan 2-0 dhe djemtë e "S. Najdenit" po me rezultat 2-1. Pra, finalët përcaktuan edhe fituesit. Në mbyllje nxënësit e "S. Najdenit" për meshkuj grumbulluan 22 pikë për vajzat 16 pikë dhe në klasifikim të përgjithshëm 38 pikë, duke merituar plotësisht vendet e para. "Nazmi Rushiti" grumbulloi nga 14 pikë si për djem ashtu dhe për vajza dhe në klasifikim të përgjithshëm 28 pikë, duke zënë vendin e dytë. Edhe pse shkolla e "N. Rushitit" pati pak fitore, duhet thënë se bënë një konkurrim me rivalitet e dinjitoz karshi talenteve të "S. Najdenit", që pse jo një pjesë e mirë stërviten me ekipet e klubit. Është i njohur fakti se kandidatët që vijnë në vitin e parë në pedagogjike fillimisht shfaqin mangësi të ndjeshme në këtë fushë. Mësuesve u duhet më shumë mund e djersë për arritje cilësore. Në mbarëvajtjen e veprimtarie të gjithë mësuesit e edukimit fizik kanë kontributin e pamohueshëm të tyre, por desha të veçoj drejtimin me kompetencë nga Fehmi Bulku, angazhimin e gjerë të S. Hasës, Sh. Qokut, Sh. Hasanit, E. Tafës, A. Lalës, M. Kazisë, E. Ketës, M. Xheladinit, Sh. Kolës, T. Kurtagës etj.

Më 21 maj u zhvilluan ceremonitë përmbyllëse pranë shkollave fituese. Kjo me objektivi sensibilizimi në të gjithë masën e shkollarëve. Merrte pjesë përgjegjëseja e seksionit të arsimit pranë bashkisë z. Anila Doda, drejtori i klubit sportiv "Korabi" Telman Përleka, drejtuesit e shkollave, trupat pedagogjike, nxënës, shikues etj., ku me të vërtetë ato u kthyen në festa sportive. Shkollave fituese të vendit të parë "Selim Alliu" dhe "Seid Najdenin" ju dhuruan kupa dhe nga nëntë topa, vendeve të dyta "Demir Gashi" dhe "Nazmi Rushit" nga gjashtë topa. Gjithashtu, vendeve nga i parë nga i tretë për shkollat, ekipet e sportistë të veçantë ju akorduan diploma. Drejtori i shkollës së mesme "Seid Najdeni" Ylber Daci pas ceremonisë shtroi një drekë për drejtuesit, angazhuesit e mësuesit e edukimit fizik të dy shkollave në restorant "Hoxha".

Ia vlen të veçojmë angazhimin me vjueshmëri dhe me seriozitet të dy drejtuesve të shkollave të mesme Ylber Daci dhe Gafur Markeçi. Përvoja flet se kur drejtuesit vihen në krye të punëve, padyshim arritjet janë më të prekshme. Edukimi olimpik, integrimi social dhe pjesëmarrja në sport e fëmijëve dhe të rinjve, përhapja e kulturës si urë lidhëse miqësie e mirëkuptimi, kalimi në mënyrë të kulturuar të kohës së lirë në shërbim të kalitjes e mirëedukimit të tyre, larg veseve e ndikimeve negative (duhanit, alkolit, drogës, fjalëve fyese, rrugaçerisë etj., mbeten nja angazhim sistematik i joni në shërbim të brezave, larg punës me fushata.

* Presidenti i Komitetit Olimpik Rajonal Dibër

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Një këngë – një histori

(Nga përmbledhja folklorike e Naim Plakut "Gurra e Korabit")

Unë jam Hasja e Kaloshit

Sheh Shashari një sheh murdar, ¹⁾
 Me shtatë gra shtajret beqar. ²⁾
 Has Kaloshit po i çon fjalë:
 - Ke një cucë due me ta marrë!
 Kemi dasëm si sot një javë,
 Ma ço Hasën n'kalë me shalë,
 N'këtë konat asht nusja e parë! ³⁾
 - Najse darsmën, o Sele Topushi,
 Rrefi lodrat, o sheh kopuki, ⁴⁾
 Mos m'i çit deshët prej vathe,
 Po t'vjen nusja me bojxhake! ⁵⁾
 - Unë jam Hasja e Kaloshit,
 Ta rras krajet ⁶⁾ n'fund të koshit!
 Unë jam Hasja e topanxhës,
 Ta cof ⁷⁾ vocin n'thes t'tërshanës!
 S'bahem nusja e sheh Murdarit,
 Se jam bija e Kalosh Hasit... ⁸⁾



e në tërë Shqipërinë që shpjegohen lehtë sipas ligjeve të gjuhës shqipe, fjalëformimit të saj. Le të ndalemi tek Kaloshi në përfaqësimin e fjalës Koleci. Zanorja "o" shqiptohet si o, ö, a, au, uo, u, kur ndodhet para buzorëve e grupeve m, b, p, mb, mp, ml, etj. P.sh. Kambë-kamë – këmbë – këmbë (trajta letrare: këmbë); shtëmbë – shtambë – shtamë – shtëmë; kanë - këne-këne-a (a e vune konen, si harrove nonen, folk). Shumësi i emrit kalë në Dibër është kol, kual (shumësi i shquar koltë-kualtë), pra kemi natyrshëm këto zhvillime: Kolë Leci-Koleci, Kaleci, Kolë Loçi a Laçi – Koloçi – Kaloçi – Kaloshi.

Vini re antitezën e fuqishme që përdor populli në këto dy vargjet e fundit, epërsinë e Kalosh Hasit para Murdarit, kryelartësinë dhe ndjenjat sipërore të tij për veprën madhore të së bijës ndaj një njeriu të lig, madhështinë e virtyeteve të shqiptarit ndaj veseve të pushtuesit, heroizmin mbarëpopullor që përfshinte gjithë komunitetin në raste të tilla ku prekej nderi e dinjiteti.

Tiranë, më 16 korrik 2007

përgatitur për të hequr qafe sheh Murdarin.

Kur sheh Shashari hyri në kur tek nusja, Hasja godet me thikë Murdarin duke e lënë të vdekur e ndërkohë u jep shenjë djemve çidhnakë të mësyjnë. Hapën dyert e kalasë e nis një luftë trup me trup ku vriten 23 meshkujt e shtëpisë, duke lënë të lira gratë. Vetëm njëri mundi të shpëtonte nga djemtë e sheh Shasharit, duke u fshehur në një thes tërshere, i vetmi nga fisi trashëgimtar i Shasharit apo Shasharakut që mbijetoi. Emri i Kalosh Hasit u bë tepër i njohur dhe e bija e tij, Hasja, simbol i qëndresës, mençurisë e trimërisë së gruas dibrane.

Për fjalën "Has-hasi-has" janë dhënë mendime të ndryshme, etimologji shpesh të gabuara, emërtime e shpjegime vulgare larg të vërtetave historike e ligjësiive gjuhësore, prandaj po mundohem të shprehem shkurt:

Has-i, has, Hasan (Hase-a), has.

1) Hasi – emër, toponim i njohur i krahinës së Hasit, që vjen në Dibër si një rudiment (mbetje) i shpërnguljeve të fiseve, e zhvendosjes së tyre nga shkaqe objektive luftërash, reprezaljesh e gjakmarrjesh, por që s'është e lehtë dhe e besueshme që të ngulitet një toponim ose mikrotoponim kaq lehtë në një vend si substrat (mbishtresë).

2) Has-e, et. em. – quhet një masiv dushku, ahu a pishë; një pyll në shpatet e gjera të një mali, pra një emër i përgjithshëm. Kujto: "Hasi i Thatë, dmth. pyll i djegur, i thatë; Hasarice (nga Has+ice – prapashtesë sllave, si Veleshicë, Leshnicë, Boboshticë etj).

3) Has – pjesës me nuanca kuptimore, përforduese e përcaktuese: është has pambuk, lesh, mëndafsh, tamam pambuk, pëlthurë e papërzier, e pastër në llojin e vet. Has dib-

Sina e Çidhnës në Dibër të Poshtme. Fshati Shashar, buzë Setës, ka pasur dikur një jetë aktive që qeverisej nga një klerik otoman i pashpirt, i quajtur Selaudin Topushi, që e quante veten zot të këtij vendi dhe mbante të shtypur e të nënshtruar mizorisht krahinën. Sot ky emër ruhet vetëm si toponim. Sheh Shashari, ose siç quhej nga populli me nofkën sheh Murdari, thuhet se kishte shtatë gra, por mendja i rrinte tek vajza e bukur Hase, që hidhte shtat në lëndinat e Sinës, mbi ujërat e kulluar të Setës. Donte të nënshtronte kësajsoj edhe fisin Kaloshi, pinjollë të Gjinit, Gjonit e Gjergj Kastriotit, prandaj i çoi fjalë Kalosh Hasit që pas një jave t'ia çonte nuse në shtëpi të bijën. Kaloshët sajuan një plan që e mendoi vetë Hasja me vëllezërit e farefisin e saj. U bë nuse dhe u nis të dhëndri plak me 30 djem çidhnakë ditën e Shënmarisë (shën Marisë) të

Kënga u dëgjua dhe u regjistrua në vitin 1958 në fshatin Arras të Dibrës. U këndua nga Man Bajraktari, vjeç 62, pa arsim.

Gjykojmë se kënga shtrihet në kufijtë e një legjende, por brenda një kuadri historik të përjetuar në fillim të shek. XVI, kur qyteti i madh i Çidhnës tashmë ishte shkretuar nga hordhitë turke dhe në tërë krahinën që vendosur pushtuesi dhe shumë klerikë myslimanë kishin marrë kompetenca të pakufizuara për të mbajtur nënshtruar me çdo mjet e mënyrë malësorët. Ndoshta kemi të bëjmë me këngën e kahmoçme "Debri Hasan" (Hasan Dibrani) që ka ardhur në turqisht deri tek ne. Fasli Suli, kafexhi në Stamboll, e kishte mësuar këngën e Hasan Kaloshit të Sinës prej hoxhë Gjoni nga fshati Mustafe i Çidhnës.

Hase Hasi ose Hase Kaloshi ishte e bija e Kalosh Hasit nga

Fillon puna në minierën e Bulqizës

(Vijon nga faqja 2)

Protestuesit qëndruan gjatë gjithë paradites para Kryesisë së Kuvendit, ku gjithashtu u përballën me indiferencën e shumicës së parlamentarëve. Katër veta humbën ndjenjat. Rasti më i rëndë ishte ai i një gruaje, të cilës i iku edhe gjuha dhe rrezikoi vdekjen. Ajo mundi të shpëtonte vetëm falë ndërhyrjes së të pranishmëve, disa nga të cilët kishin njohuri mbi ndihmën e shpejtë.

5 KORRIK 2007

Pas tre ditë protestash, nga institucioni në institucion, në përfaqësimin e partive politike, deri në Kuvendin e Shqipërisë, minatorët e Bulqizës arritën një marrëveshje me një nga drejtuesit e kompanisë Deco Metal, e cila ka blerë "Darfo"-n, vendburimet në shfrytëzim dhe asetet e kompanisë italiane. Protesta e djeshme para Sky Toëer, ku ndodhen zyrat e Deco Metal, bëri që pas disa orësh, drejtuesit e kompanisë të detyroheshin të ulen në tryezën e

bisedimeve me minatorët. Pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, përfaqësuesi i minatorëve, Dilaver Përkoçha, presidenti i Konfederatës Sindikaliste, Kolë Nikolla dhe përfaqësuesja e lëvizjes "Mjaft!", deklaruan se do të ndalen protestat publike në kryeqytet, por greva do të vazhdojë deri në një nënshkrim zyrtar të marrëveshjes. Sipas udhës së arritur, përfaqësuesit e minatorëve dhe ata të Deco Metal, do të nënshkruajnë brenda ditës së stome një marrëveshje zyrtare, e cila automatikisht vendos një rritje fillestare të pagave në masën 30 për qind. Menjëherë pas firmosjes së këtij dokumenti, 21 minatorët në grevë urie do të dalin nga ngujimi. Gjithashtu, përfaqësuesit e protestës së minatorëve deklaruan se me arritjen e këtij objekti fillestar, të hënën fillon automatikisht puna në minierën e kromit në Bulqizë.

13 KORRIK 2007

Rikthehet përsëri protesta e

minatorëve të Bulqizës. 10 ditë nga ndërprerja e grevës, e cila nisi më 1 qershor dhe mbaroi më 6 korrik, minatorët kanë protestuar për më shumë se një orë, në mjediset e brendshme të minierës së nxjerrjes së kromit.

Dalja e pagesës për muajin qershor, nuk është shoqëruar me rritjen e pages, për të cilën ishte rënë dakord midis minatorëve dhe firmës së huaj. Ka qenë pikërisht ky shkak, që i ka çuar minatorët në protestën njëorëshe të zhvilluar brenda mjedisëve të minierës.

EPILOG

Një grevë u mbyll por rezultatet e saj mbeten të dyshimta. Fakti i përsëritjes së grevës 10 ditë pas marrëveshjes tregon se negociatat nuk kanë qenë serioze në këtë proces. Ajo që mbetet pas këtij muaji grevash është vetëm shpresa: shpresa se dielli do të lindë edhe në "kryeqytetin e mjerimit", në Bulqizë!

Shpjegime fjalësh:

- Selaudin Topushi u quajt Sheh Shashari ngaqë i kishte ngritur sarajet në fshatin Shashar (ose Shasharak), sot vetëm si toponim afër fshatit Kodër-Leshe, në anën e majtë të rrjedhës së Setës, afër derdhjes së saj në Dri të Zi. Këtë sundimtar mizor populli e quajti sheh Murdari, sheh zullumqar, që shtypte pa mëshirë malësorët vendës.
- Shtajret – shtiret, që tregohet ndryshe nga ç'është.
- Nusja e parë – Zonja e parë, do të jetë më e respektuara në sarajet e sheh Shasharit. Ky sundimtar e quante veten të plotfuqishëm në tërë krahinën, në jetën dhe organizimin shoqëror të tyre, ndërhynte dhe në zakonet e ritit e trashëguara brez pas brezi, shpesh duke përlyer nderin e tyre.
- Sheh kopuki (kopuku) – i pamoral, i pandershëm, kopuk.
- Ta rras krajet – ta fus kokën me forcë në fund të koshit. Pasi i preu kokën sheh Murdarit, Hasja, me të në dorë doli me vrap të hapë dyert e sarajeve duke e hedhur kokën e tij në një kosh brenda avllisë e duke lëshuar kushtrim djemve t'u sulleshin kullave të sundimtarit turk.
- Ta cof vocin – (Shprehje pejorative, përbuzëse) – ta ngordh, ta mbyll djalin.



Progres dijesh

Regjistrimet kanë filluar.

Tel: 068 20 37 865. (04) 357 605

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi.


Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çështje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179 / 233 283

Email: lid_gazeta@yahoo.com

**Për Haxhi Hafiz
Ismet Dibrën**



Teologu dhe atdhetari i shquar Haxhi Hafiz Ismet Dibra kishte një aftësi të rrallë në parashtrimin e argumenteve, në trajtimin e një teme, në predikimet që bënte ditët e xhuma e në rastet festive. Vetëm trajtimin e temës “A ka dyshim në qenien e Zotit?” ai e ka vazhduar me javë të tëra dhe dëgjuesit ishin aq të shumtë, sa që nuk gjendej vend për të asistuar. Lënda që ai shfrytëzonte në këto raste ishte jashtëzakonisht e vlefshme, duke ndriçuar kështu rubrikat e shtypit fetar të asaj kohe “Zani i naltë”, kryeredaktor i së cilës ishte Haki Sharofi. Ekzistencën e Zotit (xh.sh) Hafizi e vërtetonte me fakte shkencore dhe në këtë kuadër përmend filozofë e shkencëtarë të kalibrit të madh. Ai merr në shqyrtim fenomenet fizike të lëvizjes e të qetësisë, ligjin e plogëtisë (inercisë) inercie dhe forcat e gjithësisme të tërheqjes e të shtytjes dhe nxjerr përfundime rreth doktrinës materialiste të teorisë atomike në historinë e natyrës. Mendje të ndritura të kulturës e të shkencës botërore vërtetojnë ekzistencën e Zotit, temë të cilën e trajtoi me aq kompetencë filozofike dijetari, filozofi dhe teologu ynë Haxhi Hafiz Ismet Dibra. Eleganca e mendimeve, terminologjia e saktë si prej studiuesi enciklopedist, forca e logjikës dhe renditja e argumenteve e ngrenë Hafizin në një shkallë të lartë që zor t’i gjendet shoku në Shqipëri në fushat që ka hulumtuar. Teolog të këtij kalibri në atë kohë numëroheshin me gishtat e njëjës dorë si Mahmud Mahiri, Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Jonuz Buliqi e ndonjë tjetër. Këta dijetarë zbatuan metoda të reja në studimet islame, sollën pikëpamjet e dijetarëve të Lindjes e të Perëndimit dhe kërkimet e tyre i ilustruan me fakte nga të gjitha fushat e dijes. Me këtë rast falenderojmë Fondacionin e Kur’anit, i cili me veprimtaritë e tij për përhapjen e fjalës së Allahut (xh.sh) po bën një punë të përkryer në vendin tonë. Ky Fondacion përveç veprimtarive kur’anore, ka marrë përsipër ringjalljen e trashëgimisë islame në Shqipëri. Këtë herë ky Fondacion sjell në duart e muslimanëve shqiptarë librin e dijetarit të madh, Haxhi Hafiz Ismet Dibra “A ka dyshim në qenien e Zotit?”. Lus Allahun (xh.sh) që ky Fondacion të ketë sa më shumë suksese në veprimtaritë e tij për t’i shërbyer sa më shumë Kur’anit famëlartë.

Kryetari i KMSH
Haxhi Selim Muça



**Dibër - SHKA “Haki Stërmilli” shfaq koncertin dibrano-kosovar
Program që impresionoi dhe freskoi publikun**

Në kuadër të manifestimit veror “Ditët e Kulturës-Dibra 2007”, në Qendrën kulturore-Dibër, të premtën mbrëma, përkatësisht më datë 20 korrik 2007, u shfaq një koncert i shkëlqyer i SHKA «Haki Stërmilli» me këngëtarë nga Dibra dhe Kosova.

Nga ajo që u prezentua në këtë koncert madhështor e cilësor, edhe njëherë u dëshmuar se, Dibra ka qenë e mbetet vatrë e ruatjes dhe kultivimit të kulturës së mirfillte artistike popullore autoktone edhe mbarëshqiptare.

Në sallën e madhe të koncerteve të mbushur përplot me dashamirë të këngës dhe valles shqipe, para art-dashësve dibranë, u paraqitën këngëtarët veteranë Violeta Turkeshi dhe Sulejman Borova, pjesëmarës në shumë evenimente kulturore dhe fitues të shumë çmimeve e mirënjohjeve. Në këtë koncert me këngët e tyre u paraqitën edhe këngëtarët e gjeneratës pas

këtyre veteranëve dhe anëtarë të SHKA “Haki Stërmilli”, si Shkëlqim Agolli, El-maz Lala, Nehat Kupa dhe Evzi Kaja, si edhe Agron Maqellara në cilësinë e këngëtarit mysafir, pasi aktualisht jeton dhe vepron në SHBA. Në mesin e tyre para publikut me mjaft sukses u paraqitën edhe këngëtarët më të rinj por shumë premtues si Laura Ostreni, Veton Sopoti, Rona Kaba dhe Bekim Hasani.

Një paraqitje dinjitoze e lakmuese pati edhe grupi i këngëve e valleve të kësaj shoqate kulturore-artistike.

Këtë koncert me pjesëmarrjen e tyre e madhëruan edhe këngëtarët e njohur kosovarë Sedat Kuqi dhe Ismet Bogujevci, të cilët me këngët e tyre, e sollën për pak çaste edhe Prishtinën në Dibër.

Për çdo lëvdatë ishte edhe orkestri i SHKA “Haki Stërmilli” nën udhëheqjen e harmonikistit Xheladin Trenova.

Në fund Argëtim Fida, Kryetar i komunës së Dibrës, për kontribut në kultivimin dhe afirmimin e këngës popullore shqipe, në emër të pushtetit vendor, u dorëzoi mirënjohje këngëtarëve Violeta Turkeshi, Sulejman Borova, dhe rapsodëve popullorë Ibrahim Lala e Misllim Strikçani, duke u shprehur se: “Është kënaqësi dhe lumturi e madhe që këto bilbila dibranë të këngës popullore shqipe t’i kemi son-te në mesin tonë, këta këngëtarë që kanë një vrrull dhe entuziazëm të pashuar dhe janë aktivë edhe sot e kësaj dite, duke kënaqur publikun dhe duke nxitur e edukuar edhe brezat e rinj”.

Ky koncert në përbërje të tri gjeneratave me këngëtarë impresionoi dhe freskoi artdashësit dibranë dhe mërgimtarët që kanë ardhur për të pushuër në vendlindjen e tyre.

Rexhep TORTE

‘Vapa kalohet më mirë në breg të Liqenit dhe valëve të Drinit’



BËNI ABONIMIN TUAJ

Në mënyrë që gazeta “Rruga e Arbërit” të jetë sa më pranë lexuesit, redaksia njofton se vazhdojnë abonimet. Abonimi vazhdon për periudhën deri në Dhjetor 2007 dhe kushton 50 lekë për numër.

Abonimet në Tiranë mund t’i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: Cel: 068 31 19 232 ose në numrat fiks (04) 357 179; 233 283.

Abonimet në Peshkopi mund t’i bëni pranë librarisë “Fleta XXI”, pranë Gjymnazit “Said Najdeni”, me nr. tel: 0218 4233.

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t’ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

Bashkëpunimet për gazetën priten deri më datë 20 të cdo muaji.